




>> ANALIZA E GJENDJES MBI EDUKIMIN PËR DROGAT NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË SHQIPËRI

Ky është një studim i bërë nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (sot ASCAP) dhe me mbështetje për publikimin e tij nga Qendra ACT for SOCIETY, Agjencia Austriake për Zhvillim, Fondacioni OAK dhe CARE International në Ballkan.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Qendrës ACT for SOCIETY, Agjencisë Austriake për Zhvillim, Fondacionit OAK dhe CARE International në Ballkan.

This is a study produced by Institute of Educational Development (IZHA/ASCAP) and supported for its publication by ACT for SOCIETY Center, Austrian Development Agency, OAK Foundation and CARE International Balkans.

Thoughts and views expressed on this report do not necessarily reflect those of ACT for SOCIETY Center, Austrian Development Agency, OAK Foundation and CARE International Balkans.



WITH FUNDING FROM
AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION



TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	4
1 PËRMBLEDHJE.....	6
2 SUMMARY.....	7
3 HYRJE	8
3.1 OBJEKTIVAT.....	9
4 RISHIKIMI I LITERATURËS	10
4.1 DROGA SI NJË PROBLEM NDËRKOMBËTAR	10
4.2 EFEKTET E DROGAVE QË ABUZOHEM MË SHUMË.....	11
4.2.1 Duhani	11
4.2.2 Alkooli.....	12
4.2.3 Marijuana	13
4.3 FAKTORËT SOCIAL	14
4.4 ADOLESHENCA SI NJË FAZË E ZHVILLIMIT.....	14
4.5 PRINDËRIMI I PAEFTKSHËM	18
4.6 MUNGESA E ATASHIMIT.....	18
4.7 FAKTORËT SOCIAL BRENDA FAMILJES DHE PARANDALIMI I ABUZIMIT ME DROGËN	19
4.8 VARFËRIA	19
4.9 EFEKTET E PËRDORIMIT TË DROGËS NË SHOQËRI	20
4.9.1 Abuzimi i drogës dhe familja	20
4.9.2 Abuzimi i drogës dhe shkolla	20
4.9.3 Politika arsimore për parandalimin e përdorimit të substancave narkotike	21
4.9.4 Metodatat dhe teknikat e edukimit për drogat.....	23
4.9.5 Format e organizimit të kurrikulës së edukimit për drogat në shkollë.....	24
5 REZULTATE TË PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE	26
5.1 ANALIZË E SHKALLËS SË PËRFSHIRJES NË KURRIKULA TË SUBSTANCAVE NARKOTIKE.....	26
5.1.1 Lënda e biologjisë	26

5.1.2	Lënda e edukimit fizik, sporte dhe shëndet	30
5.1.3	Lëndët shoqërore, qytetari, psikologji.....	33
5.1.4	Programi i lëndës “Psikologji”	34
5.2	PERCEPTIMI I NXËNËSVE, PRINDËRVE DHE MËSUESVE TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË PËR SHKALLËN E ABUZIMIT ME DROGAT NË INSTITUCIONET SHKOLLORE	35
5.2.1	Rezultatet e pyetësorëve të nxënësve	35
5.2.2	Rezultatet për mësuesit	46
5.2.3	Rezultatet për prindërit.....	57
6	PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	69
6.1	PËRFUNDIME	69
6.2	REKOMANDIME	69
7	BIBLIOGRAFIA.....	72
8	SHTOJCA	75

I PËRMBLEDHJE

Kjo analizë ofron gjetje cilësore përmes ekspertizës në evidentimin e tematikave dhe hapësirave për integrimin e çështjeve që lidhen me abuzimin me drogat, në kurrikulat e lëndëve *biologji, qytetari, psikologji, edukim fizik, sporte dhe shëndet* në cikle të ndryshme shkollimi. Për realizimin e saj u morën në shqyrtim rreth 45 programe mësimore të klasave 1-12. Analiza e gjendjes në kurrikula do të ndihmojë grupet e ekspertëve në përgatitjen e materialeve mbështetëse dhe trajnuese në trajtimin e çështjeve të drogave në procesin mësimor dhe edukativ.

Të dhënat sasiore u morën përmes pyetësorëve me nxënës, mësues dhe prindër. Për të vlerësuar shkallën e abuzimit me drogat në institucionet shkollore u anketuan 914 nxënës, 426 mësues dhe 319 prindër. Përfundimet e pyetësorëve treguan që 6,5 % nxënësve të anketuar abuzojnë me substancat narkotike. Kjo dëshmon se strategjitë për të trajtuar fenomenin ose parandaluar atë në nivel shkolle kanë nevojë të përmirësohen. Rekomandimet e këtij studimi do të ndihmojnë organizmat që funksionojnë në institucionet shkollore të formulojnë dhe zbatojnë strategji parandaluese sa më efektive për abuzimin me substancat narkotike në shkolla.

Fjalët kyçe: edukimi, kurrikula, abuzimi me substancat narkotike, institucion arsimor.

2 Summary

This analysis provides qualitative findings through the expertise in identifying topics and spaces for integrating drug-related issues into the curricula of biology, citizenship, psychology, physical education, sports and health in different education cycles. For it to be realized, about 45 programmes (syllabuses) of grades 1-12 were considered. The analysis of the situation in the curricula will help the expert groups in preparing supportive and training materials in dealing with drug issues in the teaching and educational process.

Quantitative data were obtained through questionnaires with students, teachers and parents. 914 students, 426 teachers and 319 parents were surveyed to assess the rate of drug abuse in school institutions. The findings of the questionnaires showed that 6.5% of the surveyed students abuse with narcotic substances. This proves that strategies to address the phenomenon or prevent it at the school level need to be improved. The recommendations of this study will help school-based organisms to formulate and implement effective prevention strategies for drug abuse in schools.

Keywords: education, curriculum, drug abuse, educational institution.

3 HYRJE

Përdorimi i drogës është një çështje shumë emocionale dhe problematike në shoqërinë shqiptare, për të gjitha nivelet shoqërore e shtetërore. Përdorimi i drogës dhe problemet që shkaktohen nga ajo janë më të vjetra nga sa mendojmë ne, por jo rrallë thuhet se në Shqipëri droga erdhi me demokracinë. I referohemi fazës së demokracisë për faktin se ndryshimet në kulturë, në vlerat e lëna pas, por dhe të fituara, në mënyrat e të sjellurit që u moderuan ose kërkohen të bëhen të reja për këtë sistem ekonomiko-shoqëror, u shoqëruan edhe me trauma sociale si dukuria e përdorimit të drogës nga të rinjtë.

Përdorimi dhe abuzimi me drogën në adoleshencë është një fenomen në rritje. Ndonëse ky fenomen e preku më vonë Shqipërinë se vendet e tjera, shpejtësia e përhapjes së tij është tmerrësisht e madhe. “Hapja drejt botës” përveç të mirave të saj, solli me vete dhe pasojat negative në shoqëri, ku më të prekurit janë adoleshentët. Fillimi i drogës tek adoleshentët ka arsye të ndryshme, por e përbashkëta e tyre është varësia ndaj saj.

Nxënësit të cilët abuzojnë me drogën janë nga prejardhje të ndryshme social-ekonomike. Disa janë nga familje me prindër të divorcuar, disa nga familje normale, disa nga familje të pasura e disa nga familjet e varfëra.

Droga dhe abuzimi i saj është një problem mbarëbotëror. Ai prek të gjithë sektorët e shoqërisë në të gjitha vendet. Në veçanti kjo ndikon në lirinë dhe zhvillimin e të rinjve që janë pasuria më e vlefshme në botë (UNODC, 2002). Graviteti dhe karakteristikat e këtij problemi ndryshojnë nga rajoni në rajon, dhe nga vendi në vend. Nga e kaluara e afërt, abuzimi me drogën dhe alkoolin në mesin e të rinjve është rritur në nivele të pashembullta. Sipas Raportit Botëror të Drogës, gjithsej 180 milionë njerëz abuzojnë me drogën në mbarë botën dhe shumica e tyre janë të rinj (Lakhampal dhe Agnihotri, 2007). Përveç kësaj, studimet tregojnë se alkooli, duhani dhe marihuana janë substancat më të abuzuara nga adoleshentët anembanë globit (Bourne, 2005).

Megjithatë, në vitet e fundit ka pasur një rritje të abuzimit të drogën në mesin e nxënësve që frekuentojnë shkollat në vendin tonë. Ky zhvillim ngre shqetësime pasi kjo mund t'i vinte

shumë nxënës drejt një performance të dobët akademike, probleme në sjellje dhe shëndetësore.

Edukimi që individi merr në Institucionin shkollë duhet të ndihmojë fëmijët dhe të rinjtë që në fazë vendimtare të zhvillimit të tyre të vlerësojnë dhe të kundërshtojnë rreziqe dhe presione që vijnë nga mjedisi ku rritet dhe zhvillohet.

Duke pasur parasysh nivelin në rritje të abuzimit si dhe studimet e pakta në numër që lidhen me fenomenin e drogës në shkolla u konsiderua e nevojshme kryerja e një studimi të kësaj natyre.

Pyetjet e kërkimit:

- A mundëson kurrikula kombëtare ndërtimin e dijeve që lehtësojnë zhvillimin e aftësive personale dhe sociale të nxënësve për sjellje të shëndetshme?
- A janë duke funksionuar si duhet strategjitë parandaluese në nivel shkolle?

3.1 Objektivat

Studimi duhet të:

- analizojë gjendjen e përfshirjes së çështjeve të drogës në kurrikul;
- identifikojë në kurrikulat e lëndëve biologji, qytetari, edukim fizik sporte dhe shëndet hapësirat e mundshme për zhvillimin e tematikave me fokus të veçantë kanabisin;
- ndihmojë në hartimin e materialeve mbështetëse për mësuesit në trajtimin e çështjeve të drogave dhe drejtuesit në formulimin e politikave për institucionin shkollor që drejtojnë;
- ndihmojë në hartimin e moduleve të trajnimit për përgatitjen e kapaciteteve lokale me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies për këtë dimension edukimi.

Shpresohet se gjetjet e këtij studimi të ndihmojnë në ngritjen e strategjive parandaluese sa më efektive të strukturave përgjegjëse për abuzimin e drogës tek nxënësit.

4 RISHIKIMI I LITERATURËS

Në këtë studim, rishikimi i literaturës është fokusuar në aspekte të ndryshme të abuzimit me drogën, duke përfshirë efektet e abuzimit të drogës tek adoleshentët, familjet e tyre, dhe komunitetin në tërësi.

Rishikimi i literaturës na jep një kuptim të përgjithshëm të variablave që mund të kontribuojnë në përdorimin e drogës tek adoleshentët. Literatura ka konfirmuar se përdorimi i drogës tek adoleshentët ndikon drejtpërdrejt në jetën e tyre, gjendjen fizike, shëndetin mendor, gjendjen social-emocionale, atë shëndetësore, ekonomike dhe shpirtërore.

4.1 Droga si një problem ndërkombëtar

Për shkak të statusit social-ekonomik, vendet në zhvillim e kanë më komplekse problemin me abuzimin e substancave, si alkoolin, pirjen e duhanit, përdorimin e kanabisit e marijuanës etj.

Llojet e substancave që përdoren në vendet në zhvillim janë të ndryshme nga ato në vendet e zhvilluara. Abuzuesit e drogës në vendet në zhvillim e fillojnë atë me drogat ligjore, siç është alkooli, pirja e duhanit dhe nuk shkojnë më tepër se abuzimi me kanabisin, ndërsa abuzuesit në vendet e zhvilluara mund ta fillojnë me abuzimin me alkoolin dhe kanabisin, por shpejt lëvizin drejt drogave më të rrezikshme apo me shumë tërheqje siç është ekstazia apo kokaina. Se si fillon problemi me abuzimin me drogën është i një rëndësie më të vogël në krahasim me jetët në rrezik si në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, që vjen si pasojë e tregtisë së paligjshme (UN-ODCCP, 2002).

Vendet në tranzicion apo vendet që janë të prekura nga luftërat, janë më të predispozuar për trafikimin e drogës. Këtu mund të përmendim vendet e Kaukazit, në konkluzionet e raportit të Zyrës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Trafikim, për vitin 2010, të cilat për shkak të problemeve që kanë, nuk mund të kontrollojnë si duhet trafikun e drogës brenda territoreve të tyre. Si shembull për këtë, raporti përmend Gjeorgjinë, përmes së cilës, trafiku i drogës ka shënuar rritje drejt Evropës, përmes Detit të Zi. Sa i përket rrugës së drogës në drejtim të Ballkanit, raporti thekson se ajo kalon nëpër territorin e Turqisë, saktësisht në pjesën ku ajo ka më pak autoritet shtetëror, sepse kontrollohet nga grupet

etnike Kurde. Madje, kjo pjesë përfshin një rrip të gjatë kufiri që kontrollohet nga kurdët, ndërmjet Turqisë, Iranit dhe Irakut (Gazeta Koha, 2011)

Gjithashtu dhe numri i madh i konflikteve të pazgjidhura dhe tensionet ndëretnike pamundësojnë bashkëpunimin rajonal dhe reagimin urgjent dhe efektiv në drejtim të parandalimit të trafikimit të lëndëve narkotike nëpër vendet e Ballkanit. Është ky konkluzion i raportit të Zyrës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Trafikim, për vitin 2010, në të cilin Maqedonia paraqitet si pjesë e zinxhirit ndërkombëtar (Gazeta Koha, 2011)

4.2 Efektet e drogave që abuzohet më shumë

Duhani, alkooli dhe marijuana ndikojnë në trurin e përdoruesve, duke shkaktuar vetë-administrim që substanca të përsëritet. Përdorimi i përsëritur i drogës, kohë pas kohe dhe në mënyrë të vazhdueshme, mund të çojë në sensibilizimin e qarqeve motivuese në tru dhe krijimin e varësisë ndaj saj. Në përgjithësi, trendi i përdorimit të drogave të ndryshme ndërlidhet me nivelin e rrezikut dhe aprovimin ose mosaprovimin personal, ose nga moshatarët. Drogat e përdorura kryesisht nga adoleshentët janë duhani, alkooli, marijuana, kanabis etj. (Sweetney & Neff, 2001).

4.2.1 Duhani

Duhani konsiderohet si shkrepësja e parë që duhet për t'u ndezur zjarri, në rrugën me abuzimin ndaj drogave. Fëmijët mund ta fillojnë duhanin në çfarëdo moshe. Nikotina ka demonstruar se ka lidhje të ngjashme me efekte euforike që shkakton me ato të kokainës dhe morfinës (Henning, Miyasato & Jasinski, 2004). Hapi i parë i varësisë ndaj duhanit është tepër i padukshëm, sa që fillesat e tij merren më tepër si një lojë. Duhani ka një status të veçantë që shërben si porta për zhvillimin e varësisë ndaj drogave të tjera, jo vetëm për arsyen se përdorimi i duhanit i paraprin fillimit të drogave, por sepse duhani mund të ndikojë drejtpërdrejt në zhvillimin e tolerancës nga drogat e tjera (Ronald & Davis, 2004).

Sipas Erikson dhe Mackay (2002), më shumë se 5,500 miliardë paketa duhani janë prodhuar në një vit, dhe se ka 1,2 miliardë duhanpirës anembanë botës. Kjo shifër e frikshme mund të shkojë në 2 miliardë në vitin 2030. Green, Ball dhe Ottoson (1999), shtoj se pavarësisht nga përfitimet reale të drogave psikoaktive, droga mbart nën vete dëmin e madh potencial, qoftë afat shkurtër apo afatgjatë.

Edhe pse shumë droga të tjera kanë efekt të fuqishëm, varësia nga duhani (nikotina) është po aq e fuqishme ose edhe më e madhe se prej drogave të tjera. Përdorimi i drogave të tjera më të fuqishme është jashtëzakonisht i rrezikshëm, mirëpo, individët që janë përdorues i marrin ato herë pas here. Kurse duhanxhiu konsumon nikotinë dhjetëra herë gjatë çdo dite (Stang, Krantzler & Kane, 2009).

4.2.2 Alkooli

Alkooli është droga më e disponueshme në treg, dhe nuk është e paligjshme për t'u përdorur apo zotëruar. Abuzimi i alkoolit është "një nga problemet më të vështira për t'u trajtuar sepse përdorimi është pranuar në çdo funksion social, dhe abuzuesit mohojnë se janë të varur. Alkooli është një qetësues, ky qetësues bëhet problematik kur pihet në sasi të mëdha dhe në intervale kohe të rregullta. Ai ngadalëson aktivitetin e sistemit nervor që kontrollon funksionet trupore, shkaqet e pagjumësisë, mungesës së përqendrimit, ngadalësimin në procesin e të menduarit, paaftësi në marrëdhëniet ndërpersonale, dhe çon në mosfunksionimin ekonomik dhe varfëri" (Hodge, 2001). Këta autorë theksojnë se rreziku nga konsumimi i lartë i alkoolit përfshin:

- Përkeqësim mendor;
- Mungesë vigjilence, kështu që njerëzit nën ndikimin e alkoolit janë më të prirur për të bërë aksidente;
- Dëmtimi i organeve si mëlçisë, të veshkave etj., dëm të përhershëm tek fetoja nëse abuzuesi është shtatëzanë;
- Varësi psikologjike;
- Ndërprerje të aktivitetit mendor;
- Vdekja (mbidoza).

Alkooli ndikon në trupin e njeriut si vijon (Rehn, Jenkins & Cristal 2001):

- Konfuzion, njeriu nuk mund të shohë mirë gjërat rreth tij;
- Shkuarja drejt një gjendje hutimi;
- Mund të shkaktojë gjendje kome;
- Shkakton paralizën e frymëmarrjes, ose siç njihet në fjalorin e përditshëm me termin e "ikjes së gjuhës".

4.2.3 Marijuana

Marijuana është një drogë haluçinagjene, që merret me anë të tymosjes tek përdoruesi. Efektet e marijuanës tek përdoruesi shfaqen brenda disa sekondave pas fillimit të tymosjes, dhe ato zgjasin dy deri tre orë. Marijuana ngadalëson bartjen e impulseve në tru duke bllokuar receptorët e qelizave, të cilat, në kushte normale, mundësojnë kalimin e tyre. Ajo shkakton një etje dhe një uri të panatyrshme, luhatje të pakontrolluara humori, perceptim të dëmtuar, gjykim i shqetësuar, çrregullime mendore, një ndjenjë mirëqenie dhe euforie, që të gjitha këto lehtësojnë ankthin dhe çojnë në një gjendje larg realitetit të abuzuesit (Rehn, Jenkins & Cristal 2001). Sipas këtyre autorëve, rreziqet e pirjes së marijuanës përfshijnë:

- Agresionin e tepruar kur përzjehet me alkool;
- Aksidentet që vijnë si pasojë e perceptimeve të shtrembëruara;
- Dëme fizike në formën e acarimeve bronkiale, rreziku nga kanceri i mushkërive, dëmtime të kromozomeve dhe dëmtime të ndryshme në tru;
- Kjo është hapi i parë i varësisë para se abuzuesi të kalojë në droga më të rënda;

Edhe pse përdoret në sasi më të vogla se duhani, marijuana ka efekt më të dëmshëm për sistemin e frymëmarrjes. Përdorimi i marijuanës zvogëlon aftësinë e trupit për të shkëmbyer oksigjenin dhe dioksidin e karbonit në mushkëri. Gjithashtu abuzimi me marijuanën rrit rrezikun e prekjes nga sëmundjet kardiovaskulare tek njerëzit që kanë shtypjen e lartë të gjakut. Gjithashtu ajo mund të shtojë edhe ndjeshmërinë e përdoruesit për infeksione të rrugëve të frymëmarrjes. Ky efekt mund të jetë më tepër rezultat i dobësimit të përgjithshëm të sistemit imun, sesa i një veprimi të drejtpërdrejtë në sistemin e frymëmarrjes.

Nga hulumtimet është treguar se përdorimi i madh i marijuanës dëmton aftësinë e të mësuarit, të mbajtjes mend, dhe këto vazhdojnë edhe gjatë periudhës së përdorimit. Një studim me nxënës të gjimnazit, të cilët kishin përdorur marijuanë, ka dëshmuar se ata kishin shkathtësi të dobëta përqendrimi, mbajtje mend dhe mësimi, 24 orë pasi kishin pirë dozën e fundit. Nuk është e qartë nëse problemi vazhdon të mbetet edhe për një kohë të gjatë (Pope & Yougelun-Todd, 1996).

4.3 Faktorët social

Përdorimi i drogës dhe alkoolit mund të ndryshojë në varësi të faktorëve të tillë si disponueshmëria ndaj drogës, futja e drogave të reja në treg, mënyrat e reja të administrimit, si dhe ndryshimet e shpeshta sociale. Disa faktorë luajnë një rol më të drejtpërdrejtë në problemet më abuzimin me drogat si faktorë të caktuar psikologjik, për shembull mungesa e kontrollit mbi sjelljen, depresioni ose mungesa e përkrahjes për shkak të mjedisit kaotik në shtëpi, ku nuk ka stabilitet të familjes (William & Covington, 1998). Paqëndrueshmëria familjare mund të shkaktohet nga shumë faktorë siç janë trazirat në familje dhe grindjet ndërmjet anëtarëve të familjes (Taylor & Carry, 1998).

Përdorimi i drogës apo i alkoolit në një moshë të re shton mundësinë e përdorimit të tyre në një kohë pasardhëse. Disa eksperimente me adoleshentët kanë treguar se ata mund ta ndalojnë përdorimin e drogës, ose mund të vazhdojnë ta konsumojnë atë pa ndonjë arsye konkrete (WHO, 2000).

Adoleshentët me probleme emocionale kanë më shumë gjasa që të përdorin drogën si rrugë drejt vetëvrasjes. Droga dhe alkooli mund të ulë gjykimin tek adoleshentët, gjë që çon në vetëvrasje, në situata kur ata mendojnë se janë shumë të vegjël për t'i zgjidhur problemet e tyre personale (Gordon, 2004).

Tek adoleshentët shikojmë një marrëdhënie të konsoliduar midis përdorimit të drogës dhe dhunës. Tek adoleshentët që raportohet se kanë kryer dhunë, kanë qenë përdorues të alkoolit dhe drogave të tjera. Leningson (2002) gjeti se 94% e adoleshentëve të dhunshëm raportohet të kenë përdorur alkool, 85% raportuan se kishin përdorur marijuanë dhe 55% përdorimin e disa llojeve të drogave të tjera ilegale.

4.4 Adoleshenca si një fazë e zhvillimit

Është një pyetje që gjithmonë është shtruar dhe vazhdon të shtrohet jo pa interes. Adoleshenca është një fazë e jetës së secilës qenie njerëzore, në të cilën individ përfiton aftësi e njohuri për përgjegjësitë e të rriturit. Përvojat emocionale dhe ndryshimet trupore marrin ngarkesë të lartë drejt vendosjes së raporteve të reja me botën e veten. Ajo shoqërohet me ndryshime rrënjësore, të cilat kanë të bëjnë jo vetëm me rritjen biologjike, por edhe me zhvillimin mendor, sjelljen, komunikimin etj. Në pikëpamje psikike, adoleshenca

është një periudhë krize, që përfshin njëkohësisht ndarje, shkëputje, zhvillim e vetaktivizim të vrullshëm në një klimë shndërrimesh e shpërthimesh të mëdha.

Adoleshenca nuk është thjeshtë një stinë e jetës, por një mënyrë ripërtëritjeje e psikikës, ku pasiguria dhe ankthi për të ardhmen, ndikimi i instinkteve, nevoja për përkujdesje dhe dëshira për liri, japin të gjitha së bashku mundësitë e shfaqjes mbi të cilat mund të zhvillohet vetë jeta. Pra, adoleshenca përfaqëson një kohë kalimtare nga fëmijëria në pjekurinë relative. Ajo është një moshë kritike ndryshimesh dhe përjetimesh, prandaj ndikimi i faktorëve shoqëror në të është shumë i rëndësishëm. Kohëzgjatja e adoleshencës mund të mos korrespondojë e njëjtë për të gjithë njerëzit përse u takon karakteristikave të tyre të ndryshme të zhvillimit. Në vështrim të përgjithshëm, adoleshenca është një dukuri e përbashkët për të gjithë individët, por natyrisht për secilin individ ose grup individësh ka ndryshime, që i ndeshim rëndom. Ato ndodhin për shkak të nivelit kulturor, periudhës historike dhe veçorive individuale të çdo subjekti. Duke u mbështetur në këto argumente, mund të arrijmë në përfundimin se adoleshenca pavarësisht mospërputhjeve kohore në mënyrë të plotë, përbëhet apo kalon në tri faza apo pjesë, të cilat janë: paraadoleshenca, adoleshenca e hershme dhe adoleshenca e vonë (Kaza, 2006).

Në etapën e parë, paraadoleshenca, që lidhet me rindërtimin e organizmit, zhvillimi fizik dhe fiziologjik nuk bëhet i njëtrajtshëm. Prandaj koha e pubertetit shfaqet jo në të njëjtën kohë, duke e shtrirë krizën. Ritmet e zhvillimit janë të larta, por në planin e formimit të personalitetit ka paqëndrueshmëri të madhe, megjithëse bie në sy e shprehet ndjenja e të rriturit. Shfaqen dyzime e lëkundje në karakter, të rinjtë dashurojnë vrullshëm dhe urrejnë papritmas, binden, nënshtrohen, por edhe rebelohen, paraqiten të sjellshëm e idealistë, por edhe brutalë e materialistë. Ata manifestojnë gjendje të ngritur emocionale dhe pa u kuptuar shndërrohen në pesimistë e kokëfortë, jo rrallë hutohen, përfshihen nga ndjenja e të qenit i pavlefshëm (kjo ndikon të mbyllen në vetvete). Në këtë moshë zhvillohet të menduarit teorik refleksiv, shkallë-shkallë ngrihen në një nivel më të lartë veprimet mendore: analiza, sinteza, klasifikimi, përgjithësimi etj. Lindin elementet e logjikës së të rriturit, duke u ngritur cilësia e perceptimeve, të kujtesës dhe imagjinatës.

Adoleshenca e hershme është koha e vërtetë kalimtare ndërmjet paraadoleshencës dhe rinisë. Në këtë moshë krijohet një përfytyrim fillestar për orientimin profesional, gjë e cila krijon një tendosje e frikë, pavarësisht nga zgjedhjet që mund të bëhen. Gjatë saj marrin

përparësi vlerat vetjake në krahasim me ndikimet e jashtme, ndërtohet plani jetësor dhe nevoja për intimitet është e papërballueshme. Ndjeshmëria emocionale e adoleshentëve është e lartë. Prandaj në këtë moshë shfaqen reagime të forta në çaste të papritura. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi janë mekanizma nxitës, por në pranimin e tyre real ka luhatje të mëdha.

Ndryshimet fizike dhe emocionale të ndjeshme e të shpejta ndodhin në një hapësirë kohe të caktuar. Ato zgjasin deri në arritjen e autonomisë së plotë, atëherë kur vendosen raporte emocionale instinktive të shpejta me grupe të tjera dhe me mjedisin shoqëror. Megjithatë është disi e vështirë të përcaktojmë kufirin kohor të mbylljes së adoleshencës. Frojdi e ka përcaktuar këtë afat kohën kur “adoleshenti është i aftë të dojë e të punojë,” ndërsa Erikson e përcaktoi si kohën kur i riu “është i aftë të përfshihet për një raport intim me një tjetër, duke realizuar një takim ndërmjet dy “unë-ve” të ndryshëm”. Pra, adoleshenca mbyllet kur individ i është i aftë të krijojë raporte të qëndrueshme me veten, me grupin e afërt dhe gjithë mjedisin ku jeton. Ky koncept i bazuar në aftësinë e përshtatjes me veten, me të tjerët apo me botën, tregon si ndodhin ndryshimet, që e detyrojnë individin të sillet e të formohet në bazë të raporteve që ka me mjedisin ku bën pjesë, me grupin më të afërt dhe me shndërrimet e tij të brendshme. Adoleshenca mund të karakterizohet si fazë e kalimit nga bregu i frikës dhe i ankthit në atë të strukturës funksionuese të sigurisë së të rriturit. Ky kalim nuk bëhet në një ditë, as në mënyrë të rrufeshme. Për të duhet të shmangen a të kapërcehen një mori pengesash një nga një dhe jo të grumbulluara në mënyrë absurde (Kaza, 2006).

Një i ri, edhe pse është i gatshëm të jetojë i pavarur nëpërmjet punës së tij, ende trajtohet adoleshent dhe mbetet për një farë kohe nën ndikimin e të tjerëve, veçanërisht të prindërve të tij jo vetëm për forcën e zakonit, por për efekte të tjera, kryesisht psikologjike, shoqërore dhe ekonomike. Prandaj themi që adoleshenca vazhdon e zgjatet. Kjo na bën të bindemi që edhe pse arrihet mosha 20 vjeç, individ i ende nuk e ka mbaruar këtë fazë kritike, pra ai nuk është i gatshëm të futet në botën e të rriturve. Pikërisht përballë kësaj zgjedhjeje ekziston rreziku i tërheqjes, veçanërisht kur të rinjtë nuk arrijnë të ndërtojnë raporte të drejtpërdrejta me realitetin. Për këtë arsye, në momente të tilla mund të paraqiten mundësi për t’u shfaqur te adoleshentët edhe prirje neurotike. Në të kundërt, ka nga ata të rinj që rriten përpara limiteve të caktuara kohore për arsye mbijetese, megjithëse kapacitetin, gjykimin e kritikën ende nuk e kanë të zhvilluar në nivelin e dëshiruar. Një tipar tjetër i këtij ndryshimi, është rritja e adoleshentëve me shfaqje e prirje mbrojtëse, maniake e paranojake, dukuri këto të

mundshme gjatë zhvillimit, të cilat shfaqen ose jo gjatë kësaj periudhe. Prandaj me të drejtë nga shumë studiues adoleshenca është përcaktuar si moshë e cila shoqërohet me probleme tepër të ndjeshme (Kaza, 2006).

Adoleshentët që janë konsumues të drogës nuk mund të bëjnë dot lidhjen midis veprimeve të tyre sot dhe pasojës nesër. Gjithashtu ata kanë një tendencë të ndihen imun ndaj problemeve që shqetësojnë njerëzit e tjerë (Kenny & Markou, 2004).

Ndjenja e vetes tek adoleshentët është vetëvlerësimi i adoleshentëve që shfaqet në katër fusha kryesore të zhvillimit:

- Formimin e identitetit, pavarësia, marrëdhëniet me kolegët;
- Shmangien e përdorimit të drogës dhe alkoolit;
- Ndjenjat e dobëta të vetërespektit rrisin mundësinë e përdorimit të drogave më të rënda si ekstazia dhe kokaina;
- Përfshirja e prindërve fuqishëm në marrëdhëniet me ndjenjën e adoleshentëve për veten dhe vendimet që ata marrin duke ju referuar përdorimit të alkoolit dhe drogës.

Wallace (2004) thekson rëndësinë e rolit që luan përkufizimi i vetes tek adoleshentët me predispozitën e marrjes së vendimeve shkatërruese dhe krijimin e një lidhje të qartë se “kush janë” dhe “çfarë do bëjnë ata”. Sipas Eriksonit, adoleshenti i suksesshëm është ai që i përgjigjet pyetjes “kush jam unë?”. Identiteti është qëllimi themelor në fazën e adoleshencës. Një pjesë e mirë e krizës së identitetit që përjeton rinia e sotme vjen si pasojë e kërkesave kontradiktore që ushtron shoqëria mbi të.

Për më tepër, abuzimi me alkoolin është mënyra e tyre e rebelimit kundër prindërve, ndërsa fëmijët që kanë prindër mbështetës ka më shumë gjasa të veprojnë në mënyrë të pavarur nga shokët e tyre dhe të mos i dorëzohen pijes (Bray, 2002). Prindërit kanë gjithashtu një influencë të madhe në vendimin e adoleshentëve për përdorimin ose jo të duhanit ose alkoolit (Wallace, 2004).

Sipas Elliot, Huizinga dhe Menard (1999), 72% e adoleshentëve që përdorin drogë janë pesë herë më shumë të predispozuar që të kryejnë marrëdhënie seksuale me katër apo pesë partnerë. Përzierja e përdorimit të drogës me aktivitetin seksual është veçanërisht i

rrezikshëm sa që një sjellje e tillë i ekspozon ata ndaj rrezikut të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe shtatzënive të padëshiruara.

Adoleshentët seksualisht aktiv ka më shumë mundësi të eksperimentojnë me drogat, ndërsa përdoruesit e rinj të substancave kanë më shumë gjasa për të filluar herët aktivitetin seksual dhe tendencën për të pasur partnerë të shumtë (Laura, 2000).

4.5 Prindërimi i paefektshëm

Fëmijët mund të kenë çrregullime të sjelljes ose temperament të vështirë që mund të ndikohet nga situata në familje. Për shembull, nëse prindërit apo natarët e tjerë të familjes janë konsumues të substancave, fëmijët kanë gjasa të zhvillojnë probleme emocionale, të sjelljes, kognitive dhe sociale. Shumë prej këtyre fëmijëve paraqesin një performancë të dobët në shkollë dhe një gatishmëri për lënien e saj (Barber, Bolitho & BeHand 2003).

4.6 Mungesa e atashimit

Faktori familjar është baza në çrregullimet e sjelljes dhe fillimin e përdorimit të substancave tek adoleshentët. Marrëdhëniet e dobëta me prindërit dhe edukimi i pamjaftueshëm janë shkaqet kryesore që lidhen me abuzimin e drogave tek të rinjtë (Johnson, 2000). Bronfenbrenner (2003) e sheh familjen si “një organizatë në tërësi që është më e thjeshtë se shumica e individëve apo grupeve që përfshin”. Gjatë viteve që familja është bashkë, anëtarët e saj kanë zhvilluar modele të përhershme sjellje si pasojë e sjelljeve të përsëritura. Nga kjo pikëpamje, çdo anëtar i familjes është i mësuar për të vepruar dhe përgjigjur në një mënyrë të veçantë brenda familjes.

Në rastin e problemeve me sjelljen tek adoleshentët, mungesa e familjes për të menaxhuar këto devijime, mund të krijojë një forcë të fuqishme që çon në keqpërshtatje në familje (WHO, 2000).

Lidhur me periudhën kur të rinjtë janë më të predispozuar për përdorimin e drogës, Rogers dhe McGee (2003), gjetën se periudhat më të rrezikuara janë ato të tranzicionit, kalimi nga një fazë e zhvillimit në një tjetër, por rreziku mund të vijë edhe në fetusin në barkun e nënës, ndaj shumë femra këshillohen të mos përdorin drogën gjatë shtatzënisë.

4.7 Faktorët social brenda familjes dhe parandalimi i abuzimit me drogën

Mjedisi gjithashtu është i rëndësishëm në zhvillimin e fëmijës, duke përfshirë masmedian dhe industrinë e argëtimit, institucionet komunitare, organet fetare, politike dhe sistemet ligjore, aktivitetet rekreative, shërbimet shëndetësore, trajtimi profesional dhe mundësitë ekonomike (WHO, 2000). “Faktorët e rrezikut” janë faktorët kryesorë që çojnë adoleshentët drejt abuzimit me drogën, ndërsa “faktorët mbrojtës” janë faktorët që lidhen me reduktimin e potencialit për ta përdorur (WHO, 2000).

Faktorët e rrezikut janë:

- Mjedisi kaotik në shtëpi ku prindërit përdorin substanca;
- Prindërim i pasuksesshëm, veçanërisht me fëmijët me temperament të vështirë;
- Mungesa e atashimit dhe e edukimit.

WHO (2000) identifikoi dhe faktorët mbrojtës që janë:

- Obligimet e forta familjare, lidhjet e forta;
- Monitorimi i vazhdueshëm prindëror për sjelljet e fëmijëve në familje;
- Suksesi në performancën në shkollë;
- Lidhje të forta prosociale me institucione të ndryshme, si shkolla, mjedise fetare, teatër, aktivitete sportive etj.

4.8 Varfëria

Varfëria në familje shpesh mund të çojë që fëmijët të kryejnë vepra penale të ndryshme të shoqëruara me përdorimin e drogës. Varfëria i privon adoleshentëve nevojat bazë të zhvillimit si ushqimin, veshjen dhe strehimin. Nga të dhëna të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit Shqiptar, thuhet se të rinjtë e arrestuar për vepra penale të ndryshme, vijnë nga familje me probleme ekonomike, sociale dhe që kanë braktisur shkollën. Sipas këtyre të dhënave, mungesat në shtëpi ata përpiqen t’i zëvendësojnë pikërisht përmes vjedhjeve apo grabitjeve. Disa prej tyre janë përdorues të drogave të lehta, por edhe duhanpirës që vjedhin thjesht disa paketa. Sipas burimeve policore në bashkëpunim dhe me

shërbimet psikologjike, thuhet se varfëria është ndër faktorët kryesorë që drejtojnë adoleshentët drejt sjelljeve deviante (Gazeta Shekulli, 2011).

Shkalla që një i ri është i ekspozuar ndaj trazirave sociale, ndikon në shëndetin dhe zhvillimin e tij (WHO, 2000). Adoleshentët të cilët janë në depresion, kanë vetëbesim të ulët, ndihen të keqpërshtatur në shoqëri, janë më të rriskuar ndaj zhvillimit të problemeve me drogën dhe alkoolin.

Abuzimi i adoleshentit me drogën shpesh ndodh edhe nga probleme të tjera me karakter psikologjik si çrregullimet e sjelljes, depresioni, çrregullimet e ankthit, problemet në marrëdhëniet seksuale, të cilave u bashkëngjitet përdorimi i drogës (Gayle, Dakof & Parker 2001).

4.9 Efektet e përdorimit të drogës në shoqëri

4.9.1 Abuzimi i drogës dhe familja

Bray (2002) thekson se përdoruesit e drogës fiksohen ndaj zakonit për të injoruar çdo gjë ndodh rreth tyre, duke përfshirë këtu edhe nevojat e pjesëtareve të tjerë të familjes duke çuar në avari unitetin familjar.

Ndikimi është shumë i dukshëm në familje kur ata shikojnë që një i afërm i tyre vuan pasojat e abuzimit të drogës. Por nga teoria e të mësuarit social e Bandurës dimë se fëmijët modelojnë sjelljen e tyre nga ajo çfarë shikojnë, pra kur fëmijët e vegjël shikojnë më të rriturit në familje apo prindërit e tyre duke marrë drogë, mund të besojnë se kjo është një sjellje normale dhe e pranueshme (Sweetney & Neff, 2001). Fëmijët marrin shembull prej prindërve, gjyshërve dhe vëllezërve apo motrave më të mëdhenj dhe mësojnë shumë prej tyre në sjellje dhe mendime për drogën. Nëse një anëtar i familjes përdor drogë apo alkool për t'u çlodhur ose për të harruar një problem, edhe fëmijët do t'i përdorin këto metoda për t'u çlodhur ose për të zgjidhur një problem.

4.9.2 Abuzimi i drogës dhe shkolla

Përdorimi i drogës është një problem për vazhdimësinë e shkollës tek adoleshentët, sepse ajo dëmton aftësitë akademike të nxënësit dhe ndikon në ulje të performancës. Për shembull në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nxënësit që përdorin marijuan rregullisht kanë dy herë më

shumë gjasa të marrin nota më poshtë mesatares apo të jenë mbetës, gjithashtu përdoruesit e drogës kanë dy herë më shumë gjasa të braktisjes së shkollës (Government Gazette, 1998). Sipas statistikave nga Aleanca Gjimore për Zhvillimin, del se në shkollat e mesme janë rreth 12 % e të anketuarve që përdorin drogë. Ajo që bie në sy nga anketat e zhvilluara në shkollë është fakti se në shkollat e mesme kemi 11 % të femrave që pinë drogë. Kjo tregon për pirjen në rritje të përdorimit të drogës që në moshën e adoleshencës, por dhe rritjen e shkallës së varësisë. Ndërsa lidhur me rezultatet në mësim del se rreth 5 % e përdoruesve të drogës kanë rezultate të mira, 35 % nota kaluese dhe pjesa tjetër marrëdhënie jo të mira me procesin e të nxënës (Gazeta Koha Jone, 2009).

Droga mund të prishë procesin e të nxënës. Kur disa nxënës të një klase janë përdorues të drogës, ata çojnë në sjellje të çrregullta gjatë orëve të mësimi, gjë që çon në pengimin e progresit të mësimi të kolegëve të tyre. Gjithashtu përdorimi i vazhdueshëm i drogës eliminon mundësitë për të menduar logjikisht dhe racionalisht (Douglas, 2004). Përveç kësaj, përdorimi i drogës në mjediset e shkollave sjell praktika të paligjshme sjelljeje siç mund të jetë prostitucioni, vjedhja, apo tregtia e lëndëve narkotike. Praktika të cilat nuk favorizojnë zhvillimin e një mësimi produktiv (Government Gazette, 1998).

Përsa i përket adoleshentëve që janë konsumues droge, Douglas (2004) thekson se droga shkatërron trupin, mendjen dhe shpirtin. Në shumë raste përdoruesit vijnë nga familje me prejardhje jo të qëndrueshme. Disa prej tyre mund të kenë një histori të sëmundjeve mendore në familje, disa prindër me konflikte martesore, si dhe shumë të tjerë me vështirësi ekonomike dhe sociale. Këta adoleshentë priren të jenë të paqëndrueshëm e të shfaqin shenja depresioni. Ata kanë shqetësime të shumta, ku spikasin ato psikiatrike dhe ku ndihma më e mirë për ata mund të jetë me anën e psikoterapisë intensive.

4.9.3 Politika arsimore për parandalimin e përdorimit të substancave narkotike

Shumica e vendeve në Evropë dhe më gjerë kanë politika ose strategji kombëtare/plane veprimi në lidhje me zvogëlimin e furnizimit dhe kërkesës për drogat.

Politikat arsimore për parandalimin e substancave në shtete të ndryshme mund të kategorizohen si më poshtë:

Politika në nivel shkolle për abuzimin me substancat:

Politikat arsimore për abuzimin me substancat, në disa shtete, kërkojnë që vetë shkollat t'i ndërtojnë ato për të parandaluar përdorimin e substancave dhe pasojat shëndetësore dhe sociale që vijnë prej tyre. Kjo zakonisht përfshin ndalimin, përdorimin, shitjen dhe reklamimin e substancave në mjediset e shkollës ose në pronat përreth. Rregullat e shkollave në lidhje me përdorimin e substancave shpesh përfshijnë sjelljet e mësuesve dhe të pjesëtarëve të tjerë të komunitetit shkollor si dhe politikat lidhur me trajtimin e incidenteve gjatë përdorimit të substancave.

Sanksionimi me ligj i edukimi shëndetësor dhe për përdorimin e substancave:

Politikat kombëtare të arsimit përfshijnë detyrën e shkollave për të ofruar edukim shëndetsor edhe për përdorimin e substancave dhe ofrimin e trajnimeve me këtë fokus. Ky trajnim mundësohet në kontekstin e lëndëve shkencore si biologjia në programet e edukimi fizik, programeve shëndetsore ose të shkencave sociale. Kjo nënkupton që metodologjitë dhe përmbajtjet e parandalimit janë pjesë e trajnimit të detyrueshëm të mësuesve.

Sigurimi i shërbimeve shëndetësore në shkollë:

Politikat kombëtare mandatojnë zbatimin e shërbimeve shëndetësore në shkollë. Këto shërbime lejojnë ofrimin e një game të gjerë të shërbimeve shëndetësore për nxënësit. Personeli përgjegjës përfshin infermierë shkollorë, këshillues profesionistë të shëndetit mendor etj. Shërbimet e ofruara shpesh kontribuojnë në edukimin parandalues, zhvillimin e politikave të shkollave për përdorimin e substancave, identifikimin e hershëm dhe ndërhyrjet si dhe lidhjet me sektorët social dhe shëndetësor.

Standardet kombëtare për përpjekjet parandaluese në shkolla:

Edukimi për drogat në shkolla mund të inkurajohet dhe të udhëhiqet nga Standardet e Cilësisë të cilat ndihmojnë në mbështetjen e iniciativave të politikave kombëtare dhe drejtojnë shkollat në përmbushjen e mandatit të tyre për të promovuar shëndetin dhe parandaluar përdorimin e substancave.

4.9.4 Metodatat dhe teknikat e edukimit për drogatat

Edukimi për drogatat përmes Metodave dhe Teknikave të Grupit

Shkollat ofron mundësitë më të mira për të përpunuar dhe ilustruar metodatat dhe teknikat e grupit. Përdorimi i këtyre metodave përmes edukimit formal në shkollë është më efektiv sepse:

- Është në kuadër të arsimit formal që shumica e fëmijëve dhe të rinjve mund të arrijnë të parandalojnë abuzimin me drogatat;
- Shkollat kanë struktura të përcaktuara organizative, që mundësojnë lidhje me prindërit, grupet e komunitetit, etj.;
- Mjedisi shkollor ka karakteristika të ngjashme në të gjitha vendet pavarësisht nga ndryshimet kulturore dhe shoqërore, të vendeve dhe rajoneve në botë;
- Shumë metoda të ndryshme të edukimit të drogës në shkollat mund të aplikohen edhe për grupe të tjera, për komunitetin, në shumicën e rasteve duhet të bëhen vetëm disa përshtatje;
- Shumica e eksperimentimit me drogatat fillon gjatë periudhës së shkollës kur fëmijët janë në moshën 14-18 vjeç

Modeli i informimit për drogatat

Për një kohë të gjatë, edukimi për shëndetin dhe drogën bazoheshin në informim. Kjo metodë ka qenë shumë e përhapur për një kohë të gjatë dhe konsiderohej si zgjedhje e parë në edukimin për drogatat. Ajo është ende një metodë që përdoret zakonisht. Në thelb të kësaj metode qëndron supozimi se prezantimi i informacionit faktik mbi drogatat, ndikimet biologjike, sociale dhe psikologjike, rreziqet e përdorimit të drogës dhe pasojat e saj, do të kishin mjaftueshëm ndikim parandalues. Njohja e fakteve do të çonte drejtpërdrejt në ndalimin e abuzimit me drogatat.

Modeli i edukimit afektiv

Ky model u zhvillua në vitet shtatëdhjetë dhe paraqet një model edukimi të ndryshëm ku informacioni për drogatat luan rol të vogël. Edukimi afektiv bazohet në supozimin se abuzimi me drogatat ka shkakun kryesor në personalitetin e të rinjve, vetëbesimin e ulët, pa aftësinë për të marrë vendime racionale dhe për të shprehur ndjenjat dhe pa aftësinë për zgjidhjen e

problemeve. Prandaj, qëllimi kryesor i parandalimit duhet të jetë rritja e vetëbesimit, përmirësimi i aftësive të vendimmarrjes dhe zgjidhjes së problemeve. Ky model mbështetet në parimet e psikologjisë humaniste sipas së cilës një i ri duhet të ketë zgjidhur problemet e tij/saj themelore ndërpersonale në mënyrë që rreziku i përfshirjes në abuzimin me drogat të jetë shumë më i ulët.

Modeli i ndikimit social

Ky model bazohet në Teorinë Sociale të të Nxënës të Bandurës. Sipas kësaj teorie, sjellja është rezultat i ndikimeve pozitive ose negative të mjedisit ku individ funksionon. Individët në mjedisin shoqëror, si prindërit dhe bashkëmoshatarët, mediat shpesh shërbejnë si modele të sjelljeve të përshtatshme ose jo.

Programet që synojnë edukimin kundër drogave të hartuara brenda kornizës së ndikimit social përfshijnë trajnimin për ti rezistuar ndikimit të bashkëmoshatarëve, medias dhe masmedias, lojën e roleve etj.

Modeli parandalues i aftësive për jetën

Një qasje e re më premtuese është zhvillimi i aftësive për jetën si model parandalues. Ky model ka ngjashmëri konceptuale midis *modelit të aftësive për jetën* dhe *modelit afektiv*. Ai thekson zhvillimin e ekuilibruar të aftësive personale dhe sociale të cilat ndahen në pesë dimensionë kritike të rëndësishme për të mësuarit, të menduarit, ndjenjat, vendimmarrjen, komunikimin dhe veprimin e adoleshentëve. Modeli thekson ndikimin pozitiv të bashkëmoshatarëve, të mësuarit e vlerave të tilla si: respekti, dhembshuria, përgjegjësia, ndershmëria dhe vetdisiplina. Ky program përpaket të lidhë grupet në komunitet me organizmat që funksionojnë në shkollë (mësuesit, kujdestarët, këshilltarët, prindërit, anëtarët e bordit), sepse parandalimi dhe edukimi shëndetësor është përgjegjësi kolektive e shkollës dhe e komunitetit lokal. Qasja e aftësive për jetën është një model sfidues, dhe i përshtatshëm për parandalimin e drogës dhe promovimin e shëndetit.

4.9.5 Format e organizimit të kurrikulës së edukimit për drogat në shkollë

Praktika shkollore për realizimin e edukimit për drogat në shkollë njihet si forma më të përhapura të organizimit formën a) *kroskurrikulare* b) *si lëndë më vete në kontekstin e edukimit shëndetësor*. c) *ekstrakurrikulare*.

Modeli 1: *Forma kroskurrikulare* nënkupton që edukimi për drogat i nxënësve të realizohet përmes lëndëve shkollore apo të një grupi lëndësh me të cilat edukimi për drogat lidhet ngushtë p.sh. përmes integritit në kurrikulat lëndore të biologjisë, edukimit fizik sporte dhe shëndetit, qytetarisë, dhe psikologjisë. Ky edukim mund të bazohet në materiale plotësuese ku çështje të kanabisit dhe drogave të tjera integrohen në tema të caktuara mësimore të këtyre lëndëve.

Model 2: Si *lëndë më vete* duke e përfshirë në kurrikulën e edukimit shëndetësor me orë të posaçme në planin mësimor

Model 3: *Veprimtaritë ekstrakurrikulare* të cilat nënkuptojnë planifikimin e veprimtarive në bazë shkolle, klase, në kuadër të tematika që lidhen me drogat në përgjithësi dhe kanabisin në veçanti në përputhje me kushtet e klasës, shkollës etj..

Në këtë model e gjithë shkolla në një ditë dhe orë të caktuar merr pjesë në një veprimtari ndërgjegjësuere për drogat, e cila mund të jetë një takim me një punonjës shëndetësor apo specialisti arsimit, shikimi i një filmi etj.

Veprimtari ekstrakurrikulare nuk duhet të zhvillohen veçmas por duhet të plotësojnë edukimin kundër drogave që realizon shkolla.

5 REZULTATE TË PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE

5.1 Analizë e shkallës së përfshirjes në kurrikula të substancave narkotike

5.1.1 Lënda e biologjisë

Edukimi kundër drogave në kurrikulat e arsimit parauniversitar zë vend në mënyrë eksplicite me fushat kurrikulare që kanë si pjesë të qenësishme të tyre shëndetin. Tradicionalisht lënda e biologjisë është konsideruar si një disiplinë kyçe për zhvillimin dhe promovimin e edukimit shëndetësor në shkollë pasi lidhjet përmbajtësore me të janë të forta. Një vlerësim i duhur i shëndetit kërkon domosdoshmërisht të kuptuarit e proceseve të përfshira në funksionimin normal të trupit të njeriut si dhe vlerësimin e shqetësimeve që kanë për këto procese praktikatat që konsiderohen si të dëmshme. Në kurrikulën e biologjisë, tematika të shëndetit që kanë një bazë të theksuar biologjike lidhen me "ushqimin", "seksualitetin", "sëmundjet" dhe "sjelljet". Edhe çështja e drogave në kurrikulën e biologjisë në APU i bashkëlidhet komponentit të shëndetit. Kështu kuptimin e parë për drogat nxënësit e marrin në klasën e katërt në tematikën "Sistemet e kafshët" ku zhvillojnë të kuptuarit e drogave si ilaçe. Njohuritë për drogat rimerren në klasën e tetë dhe më tej në AML të inkorporuara në tematikat që trajtojnë sistemet e trupit të njeriut. Në këto tematika nënvizohet ndikimi i drogave në funksionimin e sistemeve të trupit, rritjen, zhvillimin, sjelljen, incidencën e sëmundjeve jo ngjitëse në nivel lokal, kombëtar dhe global. Njohuritë për kanabisin nuk zënë një vend të veçantë në programet e biologjisë por strukturimi i njohurive dhe koncepteve biologjike në funksion të elementëve të shëndetit krijon hapësira për të zgjeruar trajtimin e çështjeve të drogave përfshirë kanabisin në nivele të ndryshme shkollimi dhe në përputhje me moshën.

Më poshtë paraqiten gjetjet, sipas klasave, rezultateve të të nxënësve të kompetencave të kyçe dhe rezultateve të të nxënësve të tematikave të programit të biologjisë.

III.1.2a. Tabela përmbledhëse e gjetjeve për biologjinë

Shkalla 3		
Klasa 6-7		
	Rezultatet e të nxënit të kompetencave të kyçe	Rezultatet e të nxënit të programit të biologjisë
Kompetenca personale	Nxënësi/ja - kërkon ndihmë/këshillë nga personat dhe shërbimet përkatëse për përkrahje ose mbështetje në situata të ndryshme të dyshuara/supozuara si potencialisht të rrezikshme në të cilat çënohet shëndeti fizik dhe mendor; - përshkruan ndryshimet fizike, psikike dhe emocionale të fazës së pubertetit duke paraqitur fakte për ndikimin e tyre në mënyrën (stilin) e jetesës; - shpjegon pasojat e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës dhe substancave të tjera të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit gjatë një debati ose prezantimi (me gojë ose me shkrim); - shpjegon pasojat e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës dhe substancave të tjera të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit gjatë një debati ose prezantimi (me gojë ose me shkrim); - merr pjesë ose drejton punën në grup, bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dheanëtarët e tjerë të komunitetit që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike, etj., si dhe raporton (me gojë, me shkrim) për përvojat personale të fituara.	Tematika: Sistemet e organeve njerëzore Klasa 6 Nxënësi/ja - <u>tregon</u> për ndikimin e ushqimeve, drogave, mënyrës së jetesës për funksionimin e trupit të njeriut; - <u>tregon</u> për ndikimin e ushqimeve, drogave, mënyrës së jetesës për funksionimin e trupit të njeriut. Klasa 7 Nxënësi/ja - <u>vlerëson përpjekjet</u> individuale dhe punën në grup duke respektuar perspektiva të ndryshme për çështje që lidhen me mbrojtjen e shëndetit.

Shkalla 4		
Klasa 8-9		
Kompetenca personale	Nxënësi/ja - shpjegon rëndësinë e identifikimit të personave dhe shërbimeve kompetentë të nevojshëm për mbështetje në situata që konsiderohen potencialisht të rrezikshme për shëndetin fizik dhe mendor; - reagon ndaj sjelljeve negative duke identifikuar shkaqet e paraqitjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit (p.sh. përdorimi i duhanit, alkoolit apo drogës) etj.	Klasa 8 Nxënësi/ja - përdor burime dytësore kur përshkruan efektet e duhanit; - vlerëson përpjekjet individuale dhe punën në grup duke respektuar perspektiva të ndryshme për çështje që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të organeve të frymëkëmbimit. - diskuton mënyrat për të ruajtur një zemër të shëndetshme; - diskuton si ngjizja, rritja, zhvillimi, sjellja dhe shëndeti mund të ndikohen nga dieta, drogat dhe sëmundjet. - <u>diskuton</u> mënyrat e mbrojtjes dhe kontrollit ndaj sëmundjeve.
	Kompetenca qytetare Nxënësi/ja - solidarizohet me personat në nevojë ose të rrezikuar, duke ndërmarrë veprime konkrete për afrimin e ndihmës sipas nevojës që kanë.	
Shkalla 5		
Klasa 10-11		

Kompetenca personale	Nxënësi/ja - merr pjesë ose udhëheq një grup pune, që bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit, të cilët kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj.; - bën zgjidhje të bazuara në informacione dhe në përvoja të drejta për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien nga rreziqet e ndryshme në jetën e përditshme (p.sh.: nga përdorimi i duhanit, i alkoolit, i drogave, nga marrëdhëniet e hershme seksuale, nga zgjedhjet e gabuara ushqimore, nga ekspozimi i tepruar ndaj rrezeve të diellit etj.); - vepron në jetën e përditshme në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme, duke përzgjedhur mënyra të shëndetshme jetese, dieta të lejuara nga mjeku, ushtrime të koordinuara drejt, apo duke iu përgjigjur në mënyrën e duhur situatave të rrezikshme me të cilat mund të ndeshet në jetën e përditshme.	Klasa 11 Tematika: Sistemet te bimët dhe kafshët (njeriu) - <u>mbledh dhe përdor</u> burime të ndryshme dhe të sigurta informacioni kur diskuton për sëmundje të veshkave dhe trajtimin e tyre. Tematika: Shëndeti, sëmundjet dhe ilaçet - <u>shpjegon</u> përdorimin e vaksinave dhe ilaçeve në parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve; - <u>përshkruan</u> procesin e zbulimit dhe prodhimit të ilaçeve të reja si: testimi paraklinik dhe klinik; - <u>shpjegon</u> ndikimin e stilit të jetesës, si: aktiviteti fizik, dieta, alkooli dhe duhanpirja mbi incidencën e sëmundjeve jo ngjitëse në nivel lokal, kombëtar dhe global. - <u>vlerëson</u> faktorë të mundshëm që favorizojnë zhvillimin e sëmundjeve jongjitëse te njeriu. - <u>vlerëson</u> pasojat e duhanpirjes në sistemin e frymëkëmbimit dhe sistemin e qarkullimit të gjakut.
	Shkalla 6 Klasa 12	
Kompetenca personale	Nxënësi/ja bën zgjedhje dhe merr vendime të duhura lidhur me shëndetin, dietat dhe ushtrimet në jetën e përditshme, apo në situata të paraqitura në formën e detyrave dhe aktiviteteve mësimore, kur duhet të veprojë në mënyrë të pavarur për zbatimin në praktikë të këtyre aspekteve.	Nxënësi/ja - <u>mbledh dhe përdor</u> burime të ndryshme dhe të sigurta informacioni kur diskuton për sëmundje të zemrës dhe mushkërive dhe trajtimin e tyre. - analizon fazat që çojnë në arterosklerozë, ndikimin e saj për gjendjen shëndetësore dhe faktorët që rrisin rrezikun e zhvillimit të arterosklerozës.

5.1.2 Lënda e edukimit fizik, sporte dhe shëndet

Në kuadër të reformës së kurrikulave, fushës “Edukim fizik, sporte dhe shëndet” iu dha një rëndësi e veçantë, në peshën dhe zhvillimin përmbajtësor të saj. Kurrikula e re padyshim është një vazhdim i traditës në lëndën e edukimit fizik por që ndërthuret më së miri me rrisitë dhe me tendencat e zhvillimeve të sotme evropiane në kurrikulat e arsimit para universitar.

Një nga rrisitë në programet e lëndës “Edukim fizik, sporte dhe shëndet”, është futja e njohurive mbi *edukimin shëndetësor*, si një nevojë për pajisjen e nxënësve me njohuri mbi ruajtjen dhe kultivimin e një shëndeti sa më të mirë, lidhur kjo edhe me problematikat bashkëkohore me të cilat ballafaqohet sot brezi i ri.

Për herë të parë në “Edukim fizik, sporte dhe shëndet”, edukimi shëndetësor trajtohet si një tematikë e veçantë: *“Edukim në shërbim të shëndetit, mirëqenies dhe komunitetit”*. Ndryshe nga tematikat e tjera, që kanë të bëjnë me praktikën sportive, kjo tematikë zhvillohet në klasë si orë mësimore teorike.

Tematika *“Edukim në shërbim të shëndetit, mirëqenies dhe komunitetit”* u mundëson nxënësve:

- fitimin e njohurive për ruajtjen dhe kultivimin e shëndetit të tyre dhe të të tjerëve,
- identifikimin dhe zbatimin e formave dhe teknikave për shmangien e *efekteve të stresit, lodhjes dhe mbingarkesës* në jetën e përditshme,
- njohjen me vlerat sociale të veprimtarisë fizike e sportive si kontribut në gjithë përfshirje dhe integrim social,
- njohjen me institucionet kryesore që ofrojnë informacion dhe mundësi për tu përfshirë në veprimtari fizike e sportive të organizuar,
- njohjen dhe zbatimin e formave të thjeshta të *dhënies së ndihmës së parë*,
- njohjen e *efekteve të substancave doping* në jetën e përditshme, *efektet e tyre afat-shkurtra dhe afat-gjata*, *ndikimin e tyre në vendimmarrje*, *efektet e tyre në performancën sportive*,
- njohjen e veprimtarive dhe misionin e organizatave ndërkombëtare e kombëtare anti-doping në sport.

Kurrikula e re “Edukim fizik, sporte dhe shëndet”, përmes njohurive të tematikës “Edukim në shërbim të shëndetit, mirëqenies dhe komunitetit” që zhvillohet në nivele të ndryshme shkollimi, trajton përmes çështjeve të ndryshme edhe çështjen e edukimit kundër drogave në përgjithësi dhe antidopingun në sporte në veçanti.

Më poshtë paraqiten gjetjet, sipas klasave, rezultateve të të nxënësve të kompetencave të kyçe dhe rezultateve të të nxënësve të tematikave të edukimit fizik, sportit dhe shëndetit.

III.1.a Tabela përmbledhëse e gjetjeve për Edukimin fizik, sportet dhe shëndetin

Shkalla 3			
Klasa 6-7			
Kompetenca personale	Nxënësi/ja Identifikon efektet negative të shëndeti dhe mirëqenia e tij/saj të konsumimit të duhanit dhe alkoolit.	Klasa 6 Njohuritë: Rreziqet nga përdorimi i substancave që krijojnë varësi : - Alkooli - Duhani	Nxënësi/ja Identifikon efektet negative të shëndeti dhe mirëqenia e tij/saj të konsumimit të duhanit dhe alkoolit.
Kompetenca e të nxënit	Nxënësi/ja Identifikon mënyrën e sigurt të përdorimit të medikamenteve dhe kupton se disa medikamente ndikojnë pozitivisht në shëndetin dhe mirëqenien e tij/saj.	Klasa 7 Njohuritë: Rreziqet nga përdorimi i substancave që krijojnë varësi	Nxënësi/ja Identifikon medikamente të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e tij/saj, që krijojnë varësi, si dhe disa nga efektet (shenjat) dalluese të jashtme të tyre.

Shkalla 4			
Klasa 8-9			
Kompetenca personale	Nxënësi/ja Identifikon rrezikun që vjen si pasojë e përdorimit të lëndëve droga si dhe efektin e tyre në performancën sportive.	Klasa 8 -----	-----

Kompetenca e të nxënësve	Nxënësi/ja	Klasa 9	Nxënësi/ja
	- Njeh rrezikun që vjen si pasojë e përdorimit të lëndëve droga si dhe efektin e tyre në performancën sportive.	Njohuritë: Njohur për rreziqet nga përdorimi i substancave	Njeh rreziqet nga përdorimi i substancave që krijojnë varësi : heroína dhe kokaina.

Shkalla 5-6			
Klasa 10-12			
Kompetenca personale	Nxënësi/ja	Klasa 10-11	Nxënësi/ja
	- Identifikon rrezikun që vjen si pasojë e përdorimit të lëndëve droga si dhe efektin e tyre në performancën sportive.	Njohuritë: Rreziqet nga përdorimi i drogave	- Argumenton rreth varësisë nga drogat e lehta dhe rrezikut të kalimit në përdorim të drogave të rënda. - Identifikon shenja të gjendjes së varësisë nga drogat e lehta dhe efektet afatshkurtra dhe afatgjata nga përdorimi i tyre.

Kompetenca e të nxënësve	Nxënësi/ja	Klasa 12	Nxënësi/ja
	- Njeh rrezikun që vjen si pasojë e përdorimit të lëndëve droga si dhe efektin e tyre në performancën sportive.	Njohuritë: Sporti i pastër-edukimi anti-doping	- Njeh historikun e dopingut dhe antidopingut në sport - Identifikon dhe argumenton mbi efektet e dopingut në performancën sportive - Njeh misionin dhe veprimtarinë e organizatës botërore të antidopingut. - Njeh faqe interneti (ëebsite) që japin informacion mbi veprimtarinë fizike e sportive, teknikat e dhënies së ndihmës së parë, historinë e sportit dhe Olimpizmit në Shqipëri dhe dopingut e antidopingut në sport.

5.1.3 Lëndët shoqërore, qytetari, psikologji

Çështja e drogës dhe e substancave të tjera të dëmshme si alkooli, duhani etj., janë pjesë e kurrikulës së lëndës Qytetaria për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe profesional.

Në këtë lëndë, kjo çështje trajtohet në kuadrin e temës së shëndetit, të vlerës dhe të mbrojtjes së tij nga çdo individ dhe nga shoqëria në përgjithësi.

Në lëndën e qytetarisë çështja e shëndetit trajtohet si përgjegjësi qytetare, morale dhe mbi të gjitha ligjore.

Ky program e vlerëson shëndetin si një të drejtë njerëzore dhe për këtë arsye shqyrton edhe mbrojtjen e tij në dokumentet e të drejtave të njeriut dhe në legjislacionin shqiptar, duke u përpjekur të argumentojë domosdoshmërinë e mbrojtjes me ligj të shëndetit shteti.

Rëndësi programi i kushton parandalimit të veprimit të faktorëve që e dëmtojnë shëndetin, duke i hapur rrugë dhe hapësirë trajtimit të drogës , alkoolit dhe duhanit. Në këtë aspekt, lënda e qytetarisë përdor njohuritë që ofrohen për këtë qëllim në lëndë të tilla shkencore si kimia dhe biologjia, për të argumentuar rëndësinë e masave, në plan individual e shoqëror, për të parandaluar rritjen e veprimit të faktorëve që çojnë në prodhimin, shpërndarjen e substancave narkotike dhe për të minimizuar përdorimin e tyre.

Lënda e qytetarisë vë theksin në informimin e individit dhe publikut për dëmet që substancat narkotike shkaktojnë në shëndetin e njeriut si dhe në pasojat e shumta që ato krijojnë në plan familjar, komunitar dhe shoqëror dhe ekonomik.

Për këtë arsye ajo u jep nxënësve mundësinë që përveç informacionit të përshtatshëm për substancat narkotike, të diskutojnë edhe për faktorët social, ekonomikë e individual që krijojnë shtrat të përshtatshëm për rritjen e prodhimit dhe të përdorimit të substancave narkotike në radhët e të rinjve si dhe për masat e domosdoshme që duhen ndërmarrë në nivel personal e shoqëror për të parandaluar rritjen e tyre.

5.1.4 Programi i lëndës “Psikologji”

Programi i psikologjisë përmban dy objektiva që lidhen me substancat narkotike. Ky program kërkon që shkolla dhe mësuesi të mundësojnë arritjen e këtyre objektivave që lidhen kryesisht me njohuritë për drogat dhe ndikimin që ato kanë në psikikën e njeriut nga pikëpamja e dëmeve ndaj shëndetit.

5.2 Perceptimi i nxënësve, prindërve dhe mësuesve të arsimimit të mesëm të lartë për shkallën e abuzimit me drogat në institucionet shkollore


5.2.1 Rezultatet e pyetësorëve të nxënësve

Të dhënat e përgjithshme

Në paraqitjen grafike të mëposhtme janë të dhënat për kampionin e nxënësve që i janë nënshtruar plotësisht të pyetësorit, ku numri total i kampionit që kanë marrë pjesë në këtë studim është 913 nxënës.

Nga gjetjet rezulton se DAR më numrin më të lartë të pjesëmarrësve të nxënësve është ai i Tirana Qytet (32%), ku shpërndarja në DAR-et e tjerë (të këtij rrethi) është pothuajse e ngjashme.


DAR numrin më të vogël të pjesëmarrësve të nxënësve në këtë studim është DAR Vlorë me 4,3 % të kampionit.



Grafiku nr 1: Tregon numrin e nxënësve pjesëmarrës në pyetësor, sipas DAR-ve

Në grafikun e mëposhtëm janë shprehur rezultatet në lidhje me zonën e banimit të nxënësve të cilët kanë marrë pjesë në këtë studim. Nga këto rezultate shohim se përqindjen më të lartë

të pjesëmarrësve në këtë studim e zë kampioni i nxënësve të cilët janë banues në zona urbane, përkatësisht 65,8% e kampionit, ndërsa nxënësit banues të zonave rurale zënë 34,2% të kampionit.



Grafiku nr 2: Tregon numrin e nxënësve pjesëmarrës në pyetësor, sipas zonave (vendbanimeve)

Përsa i përket shpërndarjes së gjinisë së kampionit të nxënësve shikojmë një diferencë jo shumë të ndjeshme midis gjinisë femër dhe asaj mashkull. Numrit më të madh të gjinisë pjesëmarrëse në këtë studim e zë ajo femër (58,2%), ndërsa gjinia mashkull rrjedhimisht ka përfaqësimin më të ulët (41,8%).



Grafiku nr 3: Tregon numrin e nxënësve pjesëmarrës në pyetësor, sipas gjinisë

Nga paraqitja grafike e mëposhtme ku është shprehur shpërndarja e kampionit të nxënësve sipas klasave respektive të cilës iu përkasin, rezulton se kampioni me numrin më të madh të nxënësve është ai i klasës së XI (37,9%). Në përqindje thuajse të përafërte është edhe

kampioni i nxënësve të cilët iu përkasin klasës së XII (37,2%), ndërsa përfaqësim më të vogël e ka kampioni i nxënësve që janë në klasën e X (24,9%).




Grafiku nr 4: Tregon numrin e nxënësve pjesëmarrës në pyetësor, sipas klasave

Rezultatet e pyetësorit për çdo pohim

Pohimi 1. Në pohimin 1, kërkohet përgjigje rreth informacionit që kanë nxënësit nëse në shkollën ku ata bëjnë mësim kanë dijeni për përdorimin e drogës nga shokët e tyre.

Nga përgjigjet rezulton se pjesën më të madhe e zë kampioni i nxënësve të cilët kanë shprehur se nuk kanë dijeni për nxënës që mund të jenë konsumues të drogës (68,2%). Kampioni i cili ka deklaruar se njohin nxënës që konsumojnë drogë zë përkatësisht 23,9%, ndërsa përqindjen më të vogël të kampionit e zënë nxënësit të cilët njohin dhe shoqërohen me shokë të cilët janë përdorues të drogës (7,9%).



Grafiku nr 1: Informacion a kanë dijeni për përdorimin e drogës nga shokët e tyre

Pohimi 2. A keni përdorur ndonjëherë drogë? Nëse po, sa shpesh?

Në pohimin 2 nxënësit i kërkohet përgjigje nëse ai ka konsumuar ndonjëherë drogë. Nëse nxënësi ka konsumuar drogë i kërkohet informacion dhe rreth shpeshtësisë së cilës ai e përdor drogën.

Nga rezultatet që tregohen në paraqitjen grafike rezulton që përqindjen më të madhe të kampionit e përfaqësojnë nxënësit të cilët nuk kanë konsumuar asnjëherë drogë (93,5%). Në shifra relativisht të ulëta paraqitet kampioni i nxënësve të cilët kanë deklaruar se e përdorin drogën një herë ose dy herë në vit (3,3%), ndjekur nga kamponi që ka deklaruar se e përdor drogën një herë ose dy herë në muaj (1,2%). Gjetjet tregojnë se kampioni më numrin më të vogël janë nxënësit të cilët që kanë deklaruar se e përdorin drogën disa herë në ditë ose që mund ti konsiderojmë ndryshe përdorues të rregullt, përkatësisht 0,2% e kampionit të nxënësve.




Grafiku nr 2: A kanë përdorur ndonjëherë drogë? Nëse po, sa shpesh?

Pohimi 3. Kur keni përdorur drogë për herë të fundit?


Në pohimin 3, nxënësit të cilët kanë deklaruar se kanë konsumuar drogë, iu kërkohet të shprehen rreth kohës që ata kanë përdorur drogë për herë të fundit. Nga rezultatet e përftuara vihet re se 22% deklarojnë se e kanë përdorur drogën për herë të fundit më shumë se një vit më parë, 18,6% shprehen se e kanë konsumuar drogën për herë të fundit midis 6 muaj dhe 1 vit më parë. Po ashtu në nivele të ngjashme është edhe ajo pjesë e kampionit e cila ka deklaruar se ka përdorur drogë disa javë më parë (16,9%), dhe javën e kaluar (15,3%). Ndërsa nxënësit të cilët janë shprehur se drogë kanë konsumuar drogë për herë të fundit një

ditë më parë apo ditën që kanë zhvilluar plotësimin e instrumentit ndodhen në të njëjtën përqindje, përkatësisht 13,6% secila alternativ zgjedhje.



Grafiku nr 3: Kur keni përdorur drogë për herë të fundit


Pohimi 4. Në këtë pohim kërkohet nga kampioni i nxënësve përdorues i drogës të shprehen rreth arsyes së përdorimit të saj. Nga gjetjet rezulton se kampioni i nxënësve i cili e konsumon drogën për t'u argëtuar zë përqindjen më të lartë (40,7%), i ndjekur me shifra thuajse të afërta nga nxënësit që e konsumojnë drogën pasi iu pëlqen ndjena të cilën ju jep pas përdorimit të saj (33,9%). Në nivele të ulëta rezultojnë nxënësit të cilët e përdorin drogën pasi ata ndihen nervoz, të stresuar, tensionuar, plot me shqetësime apo probleme (13,6%), pasuar nga ata që e konsumojnë drogën për tu bërë si shokët (6,8%). Ndërsa më numrit më të ulët paraqitet ajo pjesë e kampionit e cila e konsumon drogën pasi ndihen të trishtuar, të vetmuar apo janë të demoralizuar (5,1%).



Grafiku nr 4: Përdoruesit e drogës shprehen rreth arsyes së përdorimit të saj

Pohimi 5. Ku e gjeni drogën që konsumoni?

Në pohimin 5 nxënësit përdorues të drogës shprehen rreth mënyrës se si ata e sigurojnë drogën të cilën konsumojnë. Nga paraqitja grafike e mëposhtme shikohet se numrin më të lartë e zë ajo pjesë e kampionit që deklaron se drogën e siguron nga shoqëria e tyre (69%). Në nivele relativisht të lartë është edhe ajo pjesë e kampionit të nxënësve të cilët drogën e gjejnë ndërmjet personave të cilët e shpërndajnë drogën (20,7%). Nxënësit të cilët e konsumojnë drogën pasi e sigurojnë ata nga motra apo vëllezër, apo nga prindër apo të afërm është shifra të njëjta, përkatësisht zënë 5,2% secila alternativ.




Grafiku nr 5: Ku e gjeni drogën që konsumoni

Pohimi 6. Në cilën moshë keni përdorur drogën për herë të parë?

Në këtë pohim nxënësit të cilët janë shprehur se janë përdorues të drogës deklarojnë moshën në të cilën ata kanë konsumuar drogë për herë të parë. Ajo pjesë e kampionit të cilët kanë përdorur drogën për herë të parë midis grupmoshës 14-16 vjeç dhe pas moshës 16 vjeç zënë përqindjen më të madhe të kampionit dhe gjenden në shifra të njëjta, 46,5% secila.


Në përqindje të njëjtë janë nxënësit të cilët kanë konsumuar drogën për herë të parë midis moshës 12-14 vjeç dhe midis moshës 10-12, por duke theksuar që shifrat janë në nivele relativisht shumë të ulëta, 3,5% secila. Nga rezultatet shikojmë se nuk kemi asnjë nxënës i cili ka filluar përdorimin e drogës përpara moshë 10 vjeç.



Grafiku nr 6: Në cilën moshë keni përdorur drogën për herë të parë

Pohimi 7. Në çfarë kohe të ditës e përdorni drogën zakonisht?


Në pohimin 7 kërkohet informacion se në cilën pjesë të ditës nxënësit e konsumojnë zakonisht drogën. Nga gjetjet e përfutuara rezulton se kampioni i nxënësve i cili konsumon drogë e përdor atë zakonisht më tepër në mbrëmje (40,7%). Në nivele të afërta është edhe ajo pjesë e kampionit e cila e konsumon drogën pasdite pas shkollë (35,6%). Në përqindje të njëjtë është numri i nxënësve i cili e konsumon drogën zakonisht gjatë natës apo përpara shkolle ose përgjatë orarit të mësim, nga 10,2%. Rezultatet gjithashtu tregojnë se pjesëmarrësit të cilët e konsumojnë drogën në mëngjes sa zgjohen zënë pjesën më të vogël të kampionit (3,4%).



Grafiku nr 7: Në çfarë kohe të ditës e përdorni drogën zakonisht

Pohimi 8. Cila ishte arsyeja që keni përdorur drogë për herë të parë?


Nga ky pohim kërkohet informacion nga nxënësit për arsyen të cilën ata e kanë përdorur drogën për herë të parë. Nga paraqitja grafike tregohet se numrin më të madhe e zë kampioni i nxënësve të cilët e kanë filluar drogën për kureshtje (62,7%). Në nivele të larta vërehet dhe numri i nxënësve të cilët e kanë filluar drogën pasi janë shtyrë nga miqtë ose për tu argëtuar (18,6%). Kampioni i cili e ka filluar drogën për tu larguar nga problemet zë 8,5%, ndërsa kampioni që e ka filluar drogën për tu ndjerë më mirë zë 6,8% të peshës totale të kampionit i cili konsumon drogë. Rezultatet tregojnë se numrin më të vogël e zë kampioni i cili e ka filluar drogën sepse ja kanë ofruar prindërit ose të afërmit (3,4%).



Grafiku nr 8: Arsyeja që keni përdorur drogë për herë të parë

Pohimi 9. Me kë konsumoni drogë?


Ky pohim kërkon deklarimin e nxënësve për personat në shoqërinë e të cilëve ata e konsumojnë drogën. Nga rezultatet e shprehura grafikisht tregohet se nxënësit e konsumojnë drogën më së shumti me shoqërinë ose të afërme të së njëjtës moshë (57,6 %). 22% e kampionit të nxënësve të cilët kanë deklaruar që kanë përdorur drogë, shprehen se e konsumojnë atë me shoqëri më të madhe se vetja, 10,2 % e tyre më prindër ose të afërm, 6,8% e tyre shprehen se e konsumojnë vetëm, ndërsa përqindjen më të vogël e zënë nxënësit të cilët e konsumojnë drogën nën shoqërinë e motrave ose vëllezërve (3,4%).



Grafiku nr 9: Me kë konsumoni drogë

Pohimi 10. Çfarë efektesh keni pasur nga përdorimi i drogës?

Pohimi 10 kërkon informacion nga nxënësit që kanë konsumuar drogë rreth efekteve që ajo i ka shkaktuar. Nga rezultatet e shprehura grafikisht shikohet se numrin më të madh e zë ajo pjesë e kampionit që shprehet se pas përdorimit të drogës kanë ndjerë një rritje të niveleve të humorit të tyre (49,2%), e ndjekur nga nxënësit që kanë deklaruar se shprehen se janë ndjerë më të lirshëm dhe më lehtë (28,8%). (11,9%) e nxënësve të cilët konsumojnë drogë janë shprehur se pas përdorimit të saj, nga sasia të cilën kanë pirë, nuk mbajnë mend se çfarë ju ka ndodhur. Ndërsa kampioni i cili shprehet se pas përdorimit të drogës janë ndjerë të sëmurë zë 10,2% e kampionit i cili është konsumues droge.



Grafiku nr 10: Efektet nga përdorimi i drogës

Pohimi 11. Çfarë efektesh negative ka shkaktuar konsumimi i drogës në jetën tuaj?

Pohimi 11 kërkon informacion nga nxënësit efektet që ka shkaktuar përdorimi i drogës në jetën e nxënësve të cilët kanë deklaruar se kanë konsumuar drogë. Nga gjetjet shikojmë se një numër shumë i lartë i kampionit që kanë konsumuar drogë shprehen se konsumimi i drogës nuk ka sjellë asnjë efekt negativ në jetën e tyre (62,7%). 10,2% e nxënësve të cilët e shprehen se kanë konsumuar drogë, deklarojnë se ju ka hapur telashe në shtëpi apo familje, 8,5% shprehen se ka ndikuar në arritjet e tyre akademike po ashtu edhe në një përdorim më të efektshëm të kohës së shpenzuar nga ana e tyre. 5,1% e nxënësve shprehen se përdorimi i drogës ka rezultuar në përfshirjen e tyre në incidente të ndryshme, qoftë në aksidente të ndryshme, lëndime, arrestim/ndalim/shoqërim nga policia ose masë disiplinore në shkollë. Gjithashtu nxënësit shprehen se përdorimi i drogës nga ana e tyre ka ndikuar edhe në marrëdhëniet ndërpersonale, pavarësisht se këto rezultatet janë në nivele të ulëta përfaqësimi (3,4%). Nga ky pohim shikohet se pesha më e vogël si alternativ zgjedhje është deklarimi i nxënësve të cilët kanë humbur miqtë si pasojë e përdorimit të drogës (1,7%).




Grafiku nr 11: Efektet negative që ka shkaktuar konsumimi i drogës në jetën tuaj

Pohimi 12. Çfarë ndikimi ka pasur përdorimi i drogës në arritjet akademike?

Pohimi 12 kërkon informacion nga nxënësit që kanë konsumuar drogë rreth efekteve që ajo i ka shkaktuar në arritjet e tyre akademike. Nga gjetjet rezulton se më shumë se gjysma e kampionit shprehen se përdorimi i drogës nuk ka pasur asnjë efekt akademik në arritjet e tyre akademike (66,1%). 18,6% e nxënësve të cilët kanë konsumuar drogë shprehen se përdorimi i saj ka shkaktuar një rënie të lehtë e rezultateve dhe arritjeve akademike. Kampioni i nxënësve


të cilët deklarojnë se nuk kanë më dëshirë të mësojnë si pasojë e përdorimit të drogës zë 8,5%, ndërsa nxënësit të cilët janë shprehur se rrezikojnë edhe të ngelin për shkak të rezultateve shumë të dobëta që kanë zënë 6,8% të kampionit.



Grafiku nr 12: Ndikimi që ka pasur përdorimi i drogës në arritjet akademike

Pohimi 13. Si ndiheni ju personalisht për përdorimin e drogës?

Pohimi 13 kërkon informacion nga nxënësit që ata të shprehen se si ndihen ata personalisht nga përdorimi i drogës. 42,4% deklarojnë se mund ta kontrollojnë dhe mund t'i vendosin vetes kufij, alternativ e cila është përzgjedhur më së shumti nga nxënësit. 39% e tyre deklarojnë se nuk e kanë aspak problem, ndërsa 15,3% de tyre shprehen se mund ta kontrollojnë veten por kanë një influencë nga shoqëria të cilën nuk e përballojnë. Në vlera minimale paraqiten nxënësit të cilët shprehen se iu nevojitet ndihmë për ta kontrolluar veten, dhe nxënësit që janë duke marrë ndihmë nga profesionist për të bërë të mundur kontrollin e përdorimit të drogës, përkatësisht 1,7%.




Grafiku nr 13: Si ndiheni ju personalisht për përdorimin e drogës

5.2.2 Rezultatet për mësuesit

Të dhënat e përgjithshme

Në paraqitjen grafike të mëposhtme janë të dhënat për kampionin e mësuesve që i janë nënshtruar plotësimit të pyetësorit, ku numri total i kampionit që kanë marrë pjesë në këtë studim është 426 mësues.

Nga gjetjet rezulton se DAR më numrin më të lartë të pjesëmarrësve është ai i Tirana Qytet (18,5%), ku shpërndarja në DAR-et e tjerë është pothuajse në të njëjtat nivele. Ndërsa DAR me përqindjen më të vogël të pjesëmarrësve të nxënësve në këtë studim është DAR Vlorë me 2,6 % të kampionit.



Grafiku nr 1: Tregon numrin e mësuesve pjesëmarrës në pyetësor, sipas DAR-ve

Në grafikun e mëposhtëm janë shprehur rezultatet në lidhje me zonën e banimit të mësuesve të cilët kanë marrë pjesë në këtë studim. Nga këto rezultate shohim se përqindjen më të lartë të pjesëmarrësve në këtë studim e zë kampioni i mësuesve të cilët janë banues në zona urbane, përkatësisht 64,8% e kampionit, ndërsa mësuesit banues të zonave rurale zënë 32,2% të kampionit. Vihet re fakti se kemi dhe një kampion thuajse të papërfillshëm të mësuesve të cilët nuk janë përgjigjur rreth pohimit të zonës së tyre të banimit.




Grafiku nr 2: Tregon numrin e mësuesve pjesëmarrës sipas zonës së banimit

Në tabelën e mëposhtme shohim shpërndarjen e rezultateve sipas gjinisë së mësuesve pjesëmarrës në këtë studim. Nga rezultatet e gjetura shikojmë që kemi diferenca në pjesëmarrjen e mësuesve në këtë studim midis gjinisë femër dhe mashkull. Nga paraqitja grafike vëmë re që përqindje më të lartë e zënë femrat me 68,8% të pjesëmarrjes dhe meshkujt me 29,3%. Gjithashtu kemi prani të mësuesve të cilët nuk janë përgjigjur rreth përkatësisë së tyre gjinore (1,9%).



Grafiku nr 3: Tregon numrin e mësuesve pjesëmarrës sipas gjinisë


Paraqitja grafike e mëposhtme na tregon shpërndarjen e mësuesve pjesëmarrës në këtë studim sipas fushës të cilën ata ushtrojnë profesionin e tyre. Nga rezultatet e gjetura tregohet se kemi pjesëmarrje në plotësimin e këtij instrumenti të të gjitha fushave, ku përqindjen më të lartë e zënë mësuesit të cilët japin mësimin në fushën e “Gjuhët dhe komunikimi” me 27,9%, pasuar nga mësuesit e fushës “Shoqëria dhe mjedisi” me 23,2%. Nga rezultatet vëmë re se fusha me pjesëmarrjen më të ulët të mësuesve është ajo e “Teknologjia dhe TIK-u” me 4,2% dhe “Arte” me 2,6%. Gjithashtu nga gjetjet vihet re se kemi dhe një numër mësuesish të cilët nuk janë përgjigjur rreth fushës të cilën ata japin mësim apo zhvillojnë lëndët e tyre (4,5%).



Grafiku nr 4: Tregon numrin e mësuesve pjesëmarrës sipas fushave të të nxënit

Rezultatet e mësuesve

Pohimi 1. Në këtë pohim kërkohet informacion nga mësuesit pjesëmarrës në këtë studim nëse kanë dijeni për përdorimin e drogës nga nxënësit në ambientet e shkollës ku ata japin mësim. Nga gjetjet e përftuara shikohet se numri më i madh i mësuesve deklaroi se nuk kanë dijeni nëse në shkollën ku ata japin mësim konsumohet drogë (83,6%). 14,6% e mësuesve shprehen se kanë dëgjuar nga kolegët apo edhe nga nxënësit që konsumohet drogë, por personalisht nuk e kanë konstatuar një gjë të tillë. Ndërsa përqindje të papërfillshme përfaqësojnë mësuesit të cilët shprehen se kanë dije që konsumohet drogë apo edhe e kanë konstatuar një gjë të tillë. Siç shikohet edhe nga paraqitja grafike kemi 1,4% të mësuesve të cilët nuk iu janë përgjigjur këtij pohimi.



Grafiku nr 1: Dijeni për përdorimin e drogës nga nxënësit në ambientet e shkollës ku ata japin mësim

Pohimi 2. Më anën e këtij pohimi kërkohet informacion nga mësuesit në lidhje me hapat që ata kanë ndërmarrë në rast se kanë dijeni apo kanë konstatuar se në mjediset e shkollës ku ata japin mësim konsumohet drogë. Nga paraqitja grafike e treguar më poshtë shikohet se hapat e ndërmarrë nga mësuesit pas kanë pasur dijeni që konsumohet drogë apo kanë konstatuar një gjë të tillë, janë të ndryshme. 3,3% e tyre nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim, 6,6% e tyre kanë folur dhe e kanë diskutuar këtë gjë me kolegët e tyre, 7,3% kanë vënë në dijeni drejtuesit e shkollës, 3,8% e mësuesve e kanë referuar rastin tek strukturat mbështetëse të shkollës (psikologë, mjek, infermier, etj.). Ndërsa alternativa që mësuesit janë shprehur më pak kur kanë konstatuar se konsumohet drogë apo kanë qenë në dijeni është ajo e informimit të prindërve. Siç edhe shikohet nga paraqitja grafike, numrin më të lartë e zënë mësuesit të cilët nuk kanë dhënë një përgjigje, ku sqarojmë se këta mësues i përkasin kampionit të cilët në pohimin paraardhës janë përgjigjur se nuk kanë dijeni nëse në mjediset e shkollës ku ata japin mësim konsumohet drogë.



Grafiku nr 2: Hapat që ata kanë ndërmarrim në rast se kanë dijeni apo kanë konstatuar se në mjediset e shkollës ku ata japin mësim konsumohet drogë

Pohimi 3. Stafi pedagogjik ka nevojë për njohuri shtesë apo materiale të tjera burimore për të nxitur mospërdorimin e drogës nga të rinjtë.

Ky pohim përpiqet të mbledh të dhëna nga mësuesit rreth nevojës që kanë për njohuri shtesë apo materiale të tjera burimore për të nxitur mospërdorimin e drogës nga nxënësit. Nga gjetjet shikojmë se përqindjen më të madhe e zënë mësuesit që deklarojnë se janë dakord mbi nevojën për njohuri shtesë apo materiale të tjera burimore për të nxitur mospërdorimin e drogës nga të rinjtë (56,1%). Në shifra të ngjashme janë dy ekstremet e alternativave “nuk bie aspak dakord” (16,9%) dhe “bie totalisht dakord” (16%), ndërsa mësuesit e pavendosur mbi nevojën për njohuri shtesë apo materiale të tjera burimore për të nxitur mospërdorimin e drogës nga të rinjtë zënë 8% të kampionit të mësuesve pjesëmarrës. Nga rezultatet e paraqitura shikojmë se 3,1% e mësuesve nuk janë përgjigjur në lidhje me këtë pohim.



Grafiku nr 3: Stafi pedagogjik dhe nevoja për njohuri shtesë apo materiale të tjera burimore për të nxitur mospërdorimin e drogës nga të rinjtë.


Pohimi 4. Njohuritë që marrin nxënësit në shkollë për efektet e përdorimit të drogës.

Ky pohim mbledh të dhënat rreth njohurive që marrin nxënësit në shkollë për efektet e drogës. Nga rezultatet shikohet se përqindja më e madhe e kampionit të mësuesve shprehen se njohuritë që marrin nxënësit në shkollë për efektet e drogës janë të mjaftueshme (65,5%). Mësuesit të cilët mendojnë që njohuritë që marrin nxënësit në shkollë janë të pamjaftueshme zënë 27,5% të kampionit të mësuesve të anketuar. 4,2% e tyre nuk kanë dijeni nëse në shkollë merren njohuri në lidhje me efektet e përdorimit të drogës. Shumë i vogël është kampioni i cili deklaron që në shkollë nuk merret aspak njohuri për efektet e përdorimit të drogës, përkatësisht 0,7%. Gjithashtu nga rezultatet vëmë re se kemi dhe një përqindje të vogël të mësuesve të cilët nuk janë përgjigjur në lidhje me këtë pohim (2,1%).



Grafiku nr 4: Njohuritë që marrin nxënësit në shkollë për efektet e përdorimit të drogës.


Pohimi 5. Në këtë pohim mësuesve iu kërkohet të deklarojnë nëse në fushën apo lëndën që ata japin mësim, nxënësit marrin apo jo njohuri për drogën. Rezultatet tregojnë se në 42% e tyre deklarojnë se në fushën që ata japin mësim nxënësit marrin njohuri të mjaftueshme për drogën. 28,9% e mësuesve shprehen se në fushën ku ata japin mësim, nxënësit marrin njohuri të pamjaftueshme për drogën. Thuajse në të njëjtat vlera është edhe kampioni i mësuesve të cilët deklarojnë se në fushën që ata mbulojnë nxënësit nuk marrin asnjë njohuri në lidhje me drogën (27%). Gjithashtu nga gjetjet shikojmë se kemi mësues të cilët nuk janë përgjigjur në lidhje me këtë pohim (2,1%).



Grafiku nr 5: Deklarimi nëse në fushën apo lëndën që ata japin mësim, nxënësit marrin apo jo njohuri për drogën

Pohimi 6. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan edukimi i shkollës për efektet negative të drogës.


Me anën e këtij pohimi kërkohet deklarimi i mësuesve mbi dakordësinë në lidhje me rolin që luan edukimi i shkollës për efektet negative të drogës, për zgjidhjen e këtij problemi. Mësuesit që shprehen se janë dakord se për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan edukimi i shkollës për efektet negative të saj, zënë më shumë se gjysmën e pjesëmarrësve në këtë studim (59,2%), kjo vlerë pasohet nga kampioni i mësuesve që janë plotësisht dakord (31%). Nga ana tjetër, kampioni që shprehet i pavendosur dhe që nuk bie aspak dakord se për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan edukimi i shkollës për efektet negative të saj, zë përkatësisht 6,3% dhe 2,6% të numrit të mësuesve pjesëmarrës. Në vlerë shumë të vogël paraqitet kampioni i cili nuk është përgjigjur në lidhje me këtë pohim (0,9%).



Grafiku nr 6: Zgjidhja e problemeve të drogës dhe roli i edukimit në shkollë për efektet negative të drogës

Pohimi 7. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luajnë reklamat e televizorit për mospërdorimin e dograve nga të rinjtë.

Rëndësi në këtë pyetësor i është dhënë edhe propagandës që bëhet nëpërmjet reklamave të televizioneve për mospërdorimin e drogave. Nga gjetjet e përftuara rezulton një përqindje e konsiderueshme e kampionit të mësuesve (62,4%) janë shprehur se ata bien dakord se mediat luajnë rol të rëndësishëm për zgjidhjen e këtyre problemeve. 13,4% janë të pavendosur për rolin që kanë mediat për zgjidhjen e problemeve të tilla. Në paraqitjen grafike vëmë re gjithashtu se 16,7% e prindërve që bien totalisht dakord me pohimin e pyetësorit dhe vetëm 6,6% nuk bien aspak dakord me të. Siç është vënë re në çdo pohim, kemi përsëri një përqindje shumë të vogël të mësuesve të cilët nuk janë përgjigjur (0,9%).




Grafiku nr 7: Zgjidhja e problemeve të drogës dhe roli i reklamave të televizorit për mospërdorimin e dograve nga të rinjtë

Pohimi 8. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan edukimi i prindërve për efektet negative të drogës.

Paraqitja grafike e mëposhtme tregon rezultatet për sa i përket zgjidhjes së problemeve të drogës dhe rolin e rëndësishëm që luan edukimi i prindërve për efektet negative të këtyre substancave. Siç e vëmë re nga tabela, përqindjen më të lartë e zë pohimi 'bie dakord', diçka


më shumë se gjysma e kampionit të mësuesve (50,9%). Një pjesë e mirë e mësuesve (44,4%) bien totalisht dakord, ndërkohë që 3,3% prej tyre janë të pavendosur për rolin e prindërve në edukimin për efektet negative të drogës. Vetëm 0.5% e pjesëmarrësve nuk bien aspak dakord me pohimin.



Grafiku nr 8: Zgjidhja e problemeve të drogës në edukimin e prindërve për efektet negative të drogës

Pohimi 9. A ka shkolla juaj politika për parandalimin e përdorimit të drogës nga nxënësit?


Mësuesve iu është kërkuar gjithashtu të deklarojnë nëse shkolla e tyre ka politika për parandalimin e përdorimit të drogës nga nxënësit. Nga rezultatet e treguara dhe në mënyrë grafike duket qartë se peshën më të madhe e zë kampioni i cili deklaron se shkolla e tyre ka apo zbaton politika për parandalimin e përdorimit të drogës nga nxënësit. 18,1% e mësuesve pjesëmarrës në këtë studim shprehen se nuk kanë dijeni nëse në shkollën e tyre aplikohen politika për parandalimin e përdorimit të drogës nga nxënësit, ndërsa 4% shprehen se shkolla e tyre nuk ka politika në lidhje me këtë problematik. Gjithashtu vëmë re se kemi dhe një kampion prej 1,9% të cilët nuk kanë dhënë deklarin e tyre.



Grafiku nr 9: A ka shkolla juaj politika për parandalimin e përdorimit të drogës nga nxënësit

Pohimi 10. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan politikat e shkollës për nxënësit, që janë përdorues të drogës.


Me anën e këtij pohimi kërkohet deklarimi i mësuesve mbi dakordësinë në lidhje me rolin që luan politika e shkollës për nxënësit që janë përdorues të drogës, për zgjidhjen e këtij problemi. Mësuesit që shprehen se janë dakord se për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan politika e shkollës, zënë më shumë se gjysmën e pjesëmarrësve në këtë studim (60,8%), kjo vlerë pasohet nga kampioni i mësuesve që janë të pavendosur (16%). Nga ana tjetër, kampioni që shprehet totalisht dakord zë 14,3% të mësuesve pjesëmarrës. Kampioni i cili deklaron që nuk bie aspak dakord se për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan politika e shkollës, zë përkatësisht 2,6% të numrit të mësuesve pjesëmarrës. Në vlerë më të rritur së në pohimet e tjera paraqitet kampioni i cili nuk është përgjigjur në lidhje me këtë pohim (6,3%).



Grafiku nr 10: Zgjidhja e problemeve të drogës në politikat e shkollës për nxënësit, që janë përdorues të drogës

Pohimi 11. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan të pasurit e një oficeri policie të pranishëm në shkollë.

Ky pohim kërkon informacion për sa i përket pranisë së oficerit të policisë në parandalimin e përdorimit të drogës në ambientet e shkollës. 55,6% e mësuesve shprehen se janë dakord se prania e tij në shkollë do të ndihmonte në parandalimin e lëndëve narkotike në ambientet e shkollës. 23,2% e tyre deklarojnë se janë totalisht dakord se kjo do të ishte e vlefshme, duke u ndjekur nga një rezultat i afërt me 15%, të cilët shprehen të pavendosur se kjo do të ndikojë për zgjidhjen e problemit. Vetëm 5,2% e mësuesve nga ana tjetër nuk janë aspak dakord se prania e një oficeri të policisë do të ndikonte në parandalimin e drogës në ambientet e shkollës. Nga gjetjet gjithashtu rezulton se kemi dhe një kampion shumë të vogël të cilët nuk janë përgjithur në lidhje me këtë pohim (0,9%).




Grafiku nr 11: Zgjidhja e problemeve të drogës të pasurit e një oficeri policie të pranishëm në shkollë.

Pohimi 12. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan bashkëpunimi i komunitetit për ti mbajtur të rinjtë larg nga përdorimi i drogës.

Me anën e këtij pohimi kërkohet deklarimi i mësuesve mbi dakordësinë në lidhje me rolin që luan bashkëpunimi i komuniteti për të mbajtur larg të rinjtë nga përdorimi i drogës, për zgjidhjen e këtij problemi. Mësuesit që shprehen se janë dakord se për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan bashkëpunimi i komunitetit për ti mbajtur

të rinjtë larg nga përdorimi i saj, zënë më shumë se gjysmën e pjesëmarrësve në këtë studim (52,6%), kjo vlerë pasohet nga kampioni i mësuesve që janë plotësisht dakord (39%). Nga ana tjetër vihet re se kampioni që shprehet i pavendosur dhe që nuk bie aspak dakord se për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan bashkëpunimi i komunitetit për ti mbajtur të rinjtë larg nga përdorimi i saj, zë përkatësisht 6,3% dhe 1,4% të numrit të mësuesve pjesëmarrës. Në vlerë shumë të vogël paraqitet kampioni i cili nuk është përgjigjur në lidhje me këtë pohim (0,9%).




Grafiku nr 12: Zgjidhja e problemeve të drogës përmes bashkëpunimit të komunitetit për ti mbajtur të rinjtë larg nga përdorimi i drogës

5.2.3 Rezultatet për prindërit

Të dhënat e përgjithshme


Në paraqitjen e grafikut të mëposhtëm janë të dhënat e prindërve për të gjitha DAR-et e Shqipërisë, ku numri total i kampioneve, që ka marr pjesë në studim është 318 prindër. Siç vihet re nga tabela përqindja më e lartë e frekuentimit është në qytetin e Tiranës me 22 % të pjesëmarrjes. Shpërndarja e pyetësorëve ka qenë e njëjtë në të gjitha DAR-et e Shqipërisë.

Prindërit u treguan të gatshëm t'u përgjigjen pyetjeve, nga ku dolën rezultatet e studimit, të cilat janë paraqitur sipas pyetjeve në tabelat e mëposhtme.




Grafiku 1: Shpërndarja e prindërve për çdo DAR

Pyetësorët janë shpërndarë nga Drejtoritë Arsimore në mënyrë të barabartë në qytet dhe në zonat rurale. Siç vihet re nga tabela e mëposhtme zonat urbane kanë pasur pjesëmarrje më të lartë me 52.5 % të prindërve që kanë plotësuar pyetësorët.



Grafiku nr 2: Shpërndarja e prindërve sipas zonës së banimit

Në tabelën e mëposhtme shohim shpërndarjen e rezultateve sipas gjinisë. Po t'i hedhim një vështrim të shpejtë, nuk ka luhatje me diferenca të konsiderueshme midis femrave dhe meshkujve në plotësimin e pyetësorit. Në tabelë vëmë re që përqindje më të lartë e zënë femrat me 53 % të pjesëmarrjes dhe meshkujt me 47%.



Grafiku nr 3: Shpërndarja e prindërve sipas gjinisë

Në pyetësor vend të rëndësishëm zinte statusi i punësimit. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shifrat me përqindje të prindërve të punësuar, që kanë dhe përqindjen më të lartë të rezultateve me 63.1 %. Statusi i të papunëve e ndjek me pas me një shifër prej 31.1 %. Më pas renditen edhe statusi i pensionistit me 1.9 % të të anketuarve dhe në fund ‘të tjera’ që zë 3.8% të rezultateve.




Grafiku nr 4: Shpërndarja e prindërve sipas statusit të punësimit

Përqindjet në nivelin e edukimit kishin luhatje në të gjitha alternativat e sugjeruara në pyetësor. Vendin më të madh e zinin prindërit me arsim të mesëm me një përqindje prej 47.5% , duke u ndjekur më pas nga prindërit me arsim universitar me një përqindje prej 28.3%. Me një diferencë të vogël me këta të fundit ishin edhe prindërit me arsim 8/9 vjeçar me 20.1 %. Përqindjen më të vogël e vëmë re që janë prindërit me studime pasuniversitare me një shifër prej 4.1 %.



Grafiku nr 5: Shpërndarja e prindërve sipas statusit të edukimit


Pyetja e radhës ishte ajo për statusin e gjendjes civile. Përqindjen më të lartë e zinin familjet me prindër të martuar me një përqindje prej 94.3 %. Të divorcuarit zënë vendin e dytë me 2.5%. Vetëm 1.9 % rezultuan beqar/e dhe 1.3% të ve.



Grafiku nr 6: Shpërndarja e prindërve sipas statusit civil

Rezultatet specifike për prindërit

Pohimi 1. Në paraqitjen grafike të mëposhtme është paraqitur pesha se sa në dijeni janë prindërit për konsumin e drogës nga fëmijët e tyre. Siç e shohim nga rezultatet e përftuara vëmë re se përqindjen e konsiderueshme të kampionit me një shifër prej 94.3% të prindërve pohojnë se fëmija e tyre nuk ka konsumuar kurrë drogë. Për tu nënvizuar është fakti se kjo përqindje e lartë ndiqet nga 5.4% të të pyeturve që pohojnë se fëmija i tyre e ka provuar drogën dhe 0.3% pohojnë se fëmija i tyre është përdorues i drogës.



Grafiku nr 1: Pesha se sa në dijeni janë prindërit për konsumin e drogës nga fëmijët e tyre

Pohimi 2. Fëmija im merr nota të mira në shkollë.


Përsa i përket pohimit rreth rezultateve të mira në shkollë, 51.3% të prindërve kanë pohuar se fëmijët e tyre marrin shpesh nota të mira në shkollë. Kjo përqindje ndiqet nga pohimi 'shumë shpesh' që tregon frekuencën e notave të mira në shkollë. Duke vijuar më pas me pohimin 'ndonjëherë' me 13.6%. Përqindje të ulët ka marrë pohimi 'rrallë' me 7% të përgjigjeve dhe duke përfunduar me pohimin 'kurrë' që është plotësuar nga vetëm 0.9% e prindërve.



Grafiku nr 2: Fëmija im merr nota të mira në shkollë

Pohimi 3. Unë i flas fëmijës tim për efektet negative të drogës.


Grafiku i mëposhtëm tregon sa shpesh i flasin prindërit fëmijëve të tyre për efektet negative të drogës. Siç e shikojmë nga tabela përgjigjet janë të ndryshme dhe diferencat nuk janë shumë të mëdha midis pohimeve. Shumë nga prindërit, 40% prej tyre i flasin fëmijëve shumë shpesh për efektet negative të drogës. Kjo shifër ndiqet nga pohimi 'shpesh' (37.8%) me një diferencë shumë të vogël. Duke vazhduar me pohimin 'ndonjëherë' me 17.8 %, rrallë me 3.5% dhe përfundojmë me alternativën 'kurrë' me vetëm 1% të prindërve.



Grafiku nr 3: Unë i flas fëmijës tim për efektet negative të drogës

Pohimi 4. Mësuesit i flasin fëmijëve për efektet negative të drogës.

Në pohimin e mëposhtëm kërkohet informacion për bisedat që bëjnë mësuesit për efektet negative të drogës. 41.3% e prindërve pohuan se mësuesit i flasin shpesh fëmijëve për këtë çështje. 39.4% pohuan se i flasin shumë shpesh fëmijëve për efektet negative të përdorimit të drogës, ndërkohë që pohimi “ndonjëherë” është zgjedhur nga 17.8% e prindërve. Kjo ndiqet nga një përqindje më e vogël, vetëm 1.6% e prindërve, që kanë konstatuar se mësuesit i flasin rrallë fëmijëve për këtë temë.



Grafiku nr 4: Mësuesit i flasin fëmijëve për efektet negative të drogës

Pohimi 5. Shkolla flet me prindërit për parandalimin e përdorimit të drogës.

Çështja tjetër ka të bëjë me shkollën si institucion. Pohimit nëse shkolla flet me prindërit për parandalimin e përdorimit të drogës i janë përgjigjur me ‘shpesh’ një përqindje e konsiderueshme e prindërve me 43.2%. Kjo përqindje ndiqet nga pohimi ‘ndonjëherë’ me 24.8% të prindërve që e kanë pohuar. Një diferencë të vogël ka pohimi i mësipërm me pohimin ‘shumë shpesh’, i cili zë vendin e trete përsa i përket përqindjes më të lartë me 20.03 %.



Grafiku nr 5: Shkolla flet me prindërit për parandalimin e përdorimit të drogës

Pohimi 6. Forcimi i ligjit jep rezultat ne mosfutjen e drogës në shkolla.


Pohimi i mëposhtëm për forcimin e ligjit, i cili jep rezultat në mos futjen e drogës në shkolla ka rezultatet e mëposhtme: 40.1% e prindërve mendojnë se kjo është shpesh e vërtetë, duke u ndjekur me 35.4% të prindërve, të cilët mendojnë se kjo është shumë shpesh e vërtetë. Në këtë pohim vetëm 16.9% mendojnë se kjo është ndonjëherë e vërtetë dhe 5.7% i janë përgjigjur me pohimin 'rrallë'. Siç e shohim edhe nga tabela e mëposhtme pohimi 'kurrë' është përzgjedhur nga 1.9% e prindërve.



Grafiku nr 6: Forcimi i ligjit jep rezultat ne mosfutjen e drogës në shkolla

Pohimi 7. Mendoni se prania e oficerit të policisë do të parandalonte përdorimin e drogës në ambientet e shkollës.

Pohimi i mëposhtëm kërkon informacion për sa i përket pranisë së oficerit të policisë në parandalimin e përdorimit të drogës në ambientet e shkollës. 36.8% e prindërve mendojnë se shumë shpesh prania e tij në shkollë do të ndihmonte në parandalimin e lëndëve narkotike në ambientet e shkollës. 29.8% e tyre mendojnë se shpesh kjo do të ishte e vlefshme, duke u ndjekur nga një rezultat i afërt me 24.1%, të cilët mendojnë se ndonjëherë kjo do të ndikojë për mirë. Vetëm 6.7% e prindërve nga ana tjetër mendojnë se rrallë do të ndikonte në parandalimin e drogës në ambientet e shkollës dhe 2.5% mohojnë me ‘kurrë’ nuk do të parandalonte problematika të tilla.



Grafiku nr 7: Prania e oficerit të policisë do të parandalonte përdorimin e drogës në ambientet e shkollës

Pohimi 8. Droga dhe alkooli është një problem shumë i madh për të rinjtë e komunitetit.

Pohimi i mëposhtëm droga dhe alkooli është një problem shumë i madh për të rinjtë e komunitetit, nëse do të shihnim grafikun e mëposhtëm do të vinim re se shumica e prindërve me një përqindje prej 47.8% mendojnë se droga dhe alkooli shumë shpesh është një problem shumë i madh për të rinjtë e komunitetit. 36.1% prej tyre mendojnë se shpesh është problematikë. Grafiku tregon se 13.9% e prindërve mendojnë se ndonjëherë droga dhe alkooli janë problem duke u ndjekur me 1.6% të cilët janë shprehur se rrallë janë

problematika në komunitet. Vetëm 0.6% e prindërve pohojnë se droga dhe alkooli nuk janë kurrë probleme për të rinjtë e komunitetit.



Grafiku nr 8: Droga dhe alkooli është një problem shumë i madh për të rinjtë e komunitetit

Pohimi 9. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luajnë reklamat e televizioneve për mospërdorimin e drogave nga të rinjtë.

Njëra nga pohimet e pyetësorit ishte për sa i përket propagandës që bëhet nëpërmjet reklamave të televizioneve për mospërdorimin e drogave dhe një përqindje e konsiderueshme e prindërve prej 46.6% janë shprehur se ata bien dakord se mediat luajnë rol të rëndësishëm për zgjidhjen e këtyre problemeve. 27.2% janë të pavendosur për rolin që kanë mediat për zgjidhjen e problemeve të tilla. Në tabele vëmë re gjithashtu se 15.9% e prindërve bien totalisht dakord me pohimin e pyetësorit dhe vetëm 8.3% nuk bien aspak dakord me të.



Grafiku nr 9: Zgjidhja e problemeve te drogës nga reklamat e televizioneve për mospërdorimin e dograve nga te rinjtë.

Pohimi 10. Për zgjidhjen e problemeve te drogës një rol të rëndësishëm luan edukimi i prindërve për efektet negative te drogës dhe alkoolit


Tabela e mëposhtme nxjerr rezultatet e saj për sa i përket zgjidhjes së problemeve te drogës dhe rolin e rëndësishëm që luan edukimi i prindërve për efektet negative të këtyre substancave. Siç e vëmë re nga tabela, përqindjen më të lartë e zë pohimi ‘bie totalisht dakord’. Një pjesë e mirë e prindërve (43.3%) bien dakord, ndërkohë që 5.8% prej tyre janë të pavendosur për rolin e tyre ne edukimin për efektet negative të drogës. Vetëm 0.4% e të pyeturve nuk bien aspak dakord me pohimin.



Grafiku nr 10: Zgjidhja e problemeve të drogës përmes edukimit të prindërve për efektet negative të drogës dhe alkoolit

Pohimi 11. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luajnë aktivitetet pas shkollore për studentet e shkollës.

Pohimi i fundit i pyetësorit ka të bëjë me rolin që luajnë aktivitetet passhkollore për studentët e shkollës në zgjidhjen e problemeve të drogës. Nëse do t'i hedhim një sy të shpejtë tabelës do të shikojmë që pjesën më të lartë të përqindjes me një vlerë prej 52.6 % e zë pohimi bie dakord, ndërkohë që 29.6% e prindërve bien totalisht dakord pa pasur dyshime në vërtetësinë e pohimit të mëposhtëm. 13.5% e kampionit të prindërve janë të pavendosur nëse realisht këto aktivitete do të luanin rol thelbësor në zgjidhjen e problemeve dhe vetëm 4.4% mendojnë se kjo nuk është e vërtetë duke zgjedhur pohimin 'nuk bie aspak dakord'.



Grafiku nr 11: Zgjidhja e problemeve të drogës përmes aktiviteteve pas shkollore për nxënësit e shkollës.

6 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

6.1 PËRFUNDIME

Gjetjet e këtij studimi treguan se fenomeni i abuzimit me drogat është i pranishëm tek nxënësit e shkollave të mesme. Pjesa më e madhe e përdoruesve e kanë filluar kanabisin për kureshtje dhe e konsumojnë atë me shoqërinë ose të afërm të të njëjtës moshë. Arsytet e përdorimit të drogës lidhen më së shumti me marrjen e saj për kënaqësi dhe gjatë mbrëmjes.

Gjithashtu të dhënat e marra nga mësuesit treguan se vetëm një përqindje e vogël e tyre kanë dijeni se nxënësit përdorin drogë. Për këtë nevojitet një bashkëpunim i ngushtë i shkollës me strukturat e policisë për identifikimin e të rinjve që paraqesin sjellje risku. Mbi 50% e mësuesve vlerësojnë se për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan edukimi në shkollë dhe se u nevojiten materiale shtesë burimore për ta promovuar atë.

Referuar qëndrimit të prindërve, gjetjet theksojnë se një përqindje domethënëse e prindërve e konsiderojnë drogën një problem shumë të madh për të rinjtë dhe se prania e oficerit të policisë, forcimi i ligjit dhe mediat luajnë rol kyç për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Analiza e kurrikulës nxorri në pah se edukimi për drogat zë vend në mënyrë të veçantë në fushat kurrikulare që kanë si pjesë të qenësishme të tyre komponentin e shëndetit. Njohuritë për kanabisin në veçanti në kurrikulën shkollë nuk janë të mjaftueshme në vëllim dhe shtrirje. Modelet e përfshirjes së çështjeve që lidhen me drogat në kurrikula më parë ka patur në themel dhënien e informacionit faktik mbi drogat, efektet biologjike, sociale dhe psikologjike, rreziqet e përdorimit të drogës dhe pasojat e saj. Kurrikula e reformuar nënvizon se qëllimi kryesor i edukimit për drogat duhet të orientohet drejt rritjes së vetëbesimit, përmirësimit të aftësive të vendimmarrjes dhe zgjidhjes së problemeve.

6.2 REKOMANDIME

- Trajnimi me cilësi të lartë i mësuesve është thelbësor për të realizuar qëllimin kryesor të edukimit për drogat. Strukturat përgjegjëse qendrore, lokale dhe në nivel shkolle duhet

të nxisin dhe mundësojnë zhvillimin profesional të mësuesve me fokus të veçantë edukimin për drogat.

- Përgatitja e materialeve mbështetëse për mësuesit dhe drejtuesit e institucioneve shkollore si dhe hartimi i moduleve të trajnimit të realizohen në kuadër të realizimit të objektivave të planit të veprimit antikanabis nga IZHA. Gjithashtu MASR duhet të konsiderojë angazhimin e specialistëve të IZHA në trajnimet për ngritjen e kapaciteteve lokale që do të promovojnë edukimin për drogat.
- Kombinimi i formës kroskurrikulare dhe asaj ekstrakurrikulare të shihet si një ndër strategjitë për realizimin e edukimit për drogat në shkollë. Kjo nënthurë që mësuesit në përzgjedhjen e veprimtarive mësimore duhet të marrin parasysh integrimin e çështjeve të drogave me tema të tilla si: shëndeti seksual, shëndeti mendor, të ushqyerit, bulizmi etj., në mënyrë që nxënësit të kuptojnë lidhjet midis përdorimit të drogës dhe sjelljeve të riskut.
- Rishikimi i planit mësimor duke i kushtuar kohë të posaçme edukimit shëndetsor si modul i veçantë duhet marrë parasysh për vetë rëndësinë që paraqet trajtimi i çështjeve të substancave narkotike për shëndetin e të rinjtë. Edukimi shëndetsor me fokus edukimin për drogat duhet të jetë i koordinuar me ndërhyrje të tjera për këtë qëllim, siç janë politikat arsimore, shërbimet komunitare, sociale e shëndetsore, veprimtaria e mediave etj. Koordinimi me agjensi donatore dhe me programe rajonale dhe kombëtare mund të forcojë sjelljet e dëshëruara përmes një programi mbështetës për kurrikulën shkollore.
- Në bazë të nevojave të identifikuar, sugjerohet të konsiderohet "Programi Y - Qasje Inovative në Parandalimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Promovimin e Jetesës së Shëndetshme të Burrave të Rinj dhe Grave të Reja", një program i zhvilluar nga CARE International Ballkans në bashkëpunim me Instituto Promundo dhe organizatat partnere në Ballkanin Perëndimor, si aset në kurrikulën shkollore, vecanërisht seksioni i cili mbulon edukimin mbi përdorimin dhe abuzimin ndaj substancave nga të rinjtë dhe të reja. Studimi tregon se boshllëqet në kurrikulën ekzistuese mund të plotësohen nëpërmjet përdorimit të metodologjisë së përdorur në "Programin Y" - program i akredituar tashmë dhe në përdorim nga shkollat e shteteve të tjera të Ballkanit dhe i implementuar nga Qendra ACT for SOCIETY në dy gjimnaze të Qarkut Tiranë gjatë tre viteve të fundit.

- Përpos forcimit të rolit që duhet të luajë *personeli ndihmës shëndetësor* në shkollë si dhe *psikologu i shkollës* në reduktimin e sjelljeve të riskut e rekomandueshme për rritjen e sigurisë në insitucionet shkollore është dhe prania e *oficerit të sigurisë*.
- Formulimi i strategjive efektive kundër përdorimit të substancave në institucionet shkollore nevojitet të hartohen nga vetë shkollat në varësi të gjendjes së abuzimit me substancat. Strategjia e institucioneve shkollore duhet të konsistojë në:
 - përditësimin e informacionit për gjëndjen e përdorimit ose jo të substancave narkotike në shkollë, duke identifikuar nxënësit me sjellje që përbëjnë rrezik për shëndetin;
 - përgatitjen dhe zhvillimin e temave informuese shtesë për duhanin, alkolin dhe substancat abuzive (të ligjshme dhe jo të ligjshme) me qëllim rritjen e cilësisë, konsistencës, dhe koherencës në mësimdhënie;
 - përditësimin e informacionit me të rejtat më të fundit për substancat abuzive (të ligjshme dhe jo të ligjshme);
 - organizimin e takimeve individuale ose me grupmoshat e ndryshme;
 - bashkëpunimin me OJF-të, stafin pedagogjik (mësueset e lëndëve përkatëse), drejtorinë e shkollës, senatin e shkollës, gazetën e shkollës, punonjësit social, për të nxitur zbatimin e politikave anti - drogë, anti-duhan, anti- alkool, në shkollë dhe në komunitet etj.
 - shtimin e përfshirjes së të rinjve në formulimin e politikave shëndetësore për ta.

7 BIBLIOGRAFIA

Barber, D., Bolitho, F & BeHand, S. 2003. Scarce financial resources and drug addiction. Journal of Mental Disorders, vol 7, nr.2.

Bray, E. 2002. Alcohol and rebellious attitudes of adolescents to their parents. Journal of Substance Use in Young Children and Adolescents, vol 10, nr.7.

Bronfenbrenner, C. 2003. Parent-child relationship in the transition to adolescence: continuity and change in interaction. Newbury Park: Sage.

Douglas, T.E. 2004. Teens and chemical use: Perkinson's Study Report (2004). Journal on Teens and Chemical Dependence, vol 15, nr.7.

Elliot, C., Huizinga, A. & Menare, S. 1999. National youth anti-drug media campaign 1999 Report. Journal on Adolescent Drug Use and Sex, vol 7, nr.5.

Gayle, A., Dakof, T. & Parker, K. 2001. Alcohol use in families of single parents. American Journal of Alcoholism and Drug Dependence, vol 26, nr.14.

Gazeta Koha Jonë, 2009. ISHP: Drogat ne shkolla, tendence ne rritje çdo vit, shtuar më 08/05/2009 http://www.kohajone.com/html/artikull_41968.html.

Gazeta Koha, 2011. Tensionet ndëretnike favorizojnë drogën. Shtuar më 09/07/2011, ora 14:05 <http://www.albeu.com/magedoni/tensionet-nderetnike-favorizojne-drogen-/40858>.

Gordon, C. 2004. Fighting against adolescent drug abuse and addiction. American Journal of Early Addiction to Drugs, vol 20, nr.12.

Government Gazette.1998. National Drug Master Plan..

Green, S.J., Ball, D.S. & Ottoson, P.T. 1999. Drug abuse and crime. Washington, DC: Executive Office of the President.

Henning, J.E., Miyasato, K. & Jasinski, BR. 2004. Cigarette smokers and selfadministering of intravenous nicotine. American Journal of Physical Medicine and Rehabilitation, vol 2, nr.3.

Hodge, K., McLellan, A.T. & Cerbone, FG. 2001. Açessing substance abuse treatment. Journal of Nervous and Mental Diseases, vol 19, nr.10.

IZHA, 2017. Programi Dituri natyre klasa 4.

IZHA, 2017. KURRIKULA ME ZGJEDHJE Lënda: Psikologji Shkalla: VI Klasa: XII

IZHA, 2016. Lënda: Biologji Shkalla:VI. Klasa: XII.

IZHA, 2015. Program lëndor fusha: Shkenca natyrore , shkalla III-IV. Klasa VI.

IZHA, 2016. Kurrikula e bazuar në kompetenca. Lënda: Biologji Klasa: VII.

IZHA, 2016. Kurrikula e bazuar në kompetenca. Lënda: Biologji Klasa: VIII.

IZHA, 2016. Kurrikula bërthamë: Lënda: Shkencat e natyrës (fizikë, kimi, biologji). Klasa: X-XI.

IZHA, 2016. Kurrikula e bazuar në kompetenca. Lënda: Edukim fizik, sporte dhe shëndet Shkalla: III Klasa: VI.

IZHA, 2016. Kurrikula e bazuar në kompetenca. Lënda: Edukim fizik, sporte dhe shëndet Shkalla: III Klasa: VII.

IZHA, 2016. Kurrikula bërthamë: Edukim fizik, sporte dhe shëndet Shkalla: IV Klasa: X.

IZHA, 2016. Kurrikula bërthamë: Edukim fizik, sporte dhe shëndet Shkalla: IV Klasa: XI.

IZHA, 2016. Kurrikula bërthamë: Edukim fizik, sporte dhe shëndet Shkalla: IV Klasa: XII.

IZHA, 2016. Kurrikula bërthamë Lënda: Qytetari Klasa: X

Kaza, N. 2006, Tiranë. Adoleshenca – Stina e shpërthimeve.

Kenny, D. & Markou, L. 2004. National Asian Pacific and Substance Abuse Report: Trends in the Well being of American youth. Washington, DC: NIDA Publications <http://aspehhs.gov/hsp/ootrends/index.htm>. (Açessed 15 November 2005 at 09:45).

Laura, D. 2000. Factors associated with childhood sexual experience in a nonclinical female population. *Journal of Abnormal Psychology*, vol 27, nr.16.

Leningson, J.L. 2002. Survey on violence of teens and alcohol use. *Journal of Adolescent Psychiatric Problems*, vol 20, nr.4.

MAS, 2014. Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar.

Pope, H & Yurelun-Todd. 1996. The residual cognitive effects of heavy marijuana use in collage students. *Journal of the American Medical Association*.

Rehn, M. Jenkins, J. & Cristal, A. 2001. Relationships matter: impact of parental and peer factors on teen and young adult substance abuse. *American Journal of Public Health*.

Rogers, B. & Me Gee, A. 2003. Substance abuse and domestic violence. *Violence against Women*, vol 9, nr.15.

Ronald, B. & Davis, L. 2004. *Tobaço and its dependence in adolescents*. New York: Haworth Press.

Stang, L., Krantzler, N & Kane, W. 2009. ALB-MED. Fakte Shëndetësore, Alkooli dhe drogat e tjera.

Sweetney, R. & Neff, M. 2001. Current rates of drug use are unchanged. *American Journal of Family Physical Disability*, vol 40, nr.6.

Taylor, C. & Carry, P. 1998. Family and social influence on the development of the child's competence. New York: Wiley.

United Nations on Drug Control and Crime Prevention (UN-ODCCP. 2002). *World Health Report 2002*. New York: Guilford Press.

Wallace, S. 2004. The dangers of self-administered intravenous drugs. *American Journal of Drug Use Outcomes*, vol 9, nr.4.

World Health Organization (WHO). 2000. *Global status report on alcohol use Worldwide*. Geneva: WHO.

8 SHTOJCA

PYETËSOR PËR NXËNËSIT

DAR/ZA: _____

Zona: Gjinia:

☐

Urbane

☐

Rurale

☐

Femër

☐

Mashkull

Klasa:

☐

X

☐

XI

☐

XII

Për pohimet e mëposhtme ju lutem rrethoni alternativën që ju karakterizon.

1. Në shkollën ku unë bëj mësim:

1. Nuk kam dijeni për nxënës që mund të jenë konsumues të drogës¹
2. Njoh nxënës që konsumojnë drogë
3. Njoh dhe shoqërohem me nxënës që konsumojnë drogë

2. A keni përdorur ndonjëherë drogë? Nëse po, sa shpesh?

1. Kurrë
2. Një herë ose dy herë në vit
3. Një herë ose dy herë në muaj
4. Çdo fundjavë
5. Disa herë në javë
6. Çdo ditë
7. Disa herë në ditë

¹ Termi “drogë” që ju do të gjeni më poshtë gjatë pohimeve i referohet lëndës narkotike të kanabisit, marjuanës dhe hashashit.

Shënim: Nëse në pohimin nr. 2 nxënësi deklaron se nuk ka përdorur kurrë hashash (rrethon alternativën “1”), nuk vazhdon me plotësimin e pyetësorit!

3. Kur keni përdorur hashash për herë të fundit?:

1. Më shumë se një vit më parë
2. Midis 6 muaj dhe 1 vit më parë
3. Disa javë më parë
4. Javën e kaluar
5. Dje
6. Sot

4. Zakonisht filloj të përdor drogë sepse:

1. Më pëlqen ndjenja
2. Të bëhem si shokët
3. Vetëm për t'u argëtuar
4. Ndihej i stresuar, nervoz, i tensionuar, plot shqetësime apo probleme
5. Ndihej i trishtuar, i vetmuar, më vjen keq për veten time

5. Ku e gjeni drogën që konsumoni:

1. Me ndihmën e prindërve ose të afërmve
2. Nga vëllai apo motra
3. Nga shoqëria
4. E blej tek persona që shpërndajnë drogë

6. Në cilën moshë keni përdorur drogën për herë të parë?

1. Përpara moshës 10 vjeç
2. Midis moshës 10-12 vjeç
3. Midis moshës 12-14 vjeç
4. Midis moshës 14-16 vjeç
5. Pas moshës 16

7. Në çfarë kohe të ditës e përdorni drogën zakonisht?

1. Në mbrëmje
2. Pasdite pas shkolle
3. Përpara shkolle ose përgjatë orarit të mësimi
4. Në mëngjes sa zgjohej
5. Gjatë gjumit të natës

8. Cila ishte arsyeja që keni përdorur drogë për herë të parë?

1. Kureshtje
2. Ma kanë ofruar prindër ose të afërm
3. Miqtë më inkurajuan; Për t'u argëtuar

4. Për t'u larguar nga problemet e mia
5. Për tu ndjerë më mirë

9. Me kë konsumoni drogë?

1. Me prindërit ose të afërm
2. Me motrat ose vëllezërit
3. Me shoqërinë ose të afërm të së njëjtës moshë
4. Me shoqëri më të madhe se vetja në moshë
5. Vetëm

10. Çfarë efektesh keni pasur nga përdorimi i drogës?

1. Ndihehem më lirshëm dhe më lehtë
2. Ndjenjë humori e rritur
3. Jam ndjerë i sëmurë
4. Kam pirë shumë dhe të nesërmen se mbaj mend çfarë ka ndodhur

11. Çfarë efektesh negative ka shkaktuar konsumimi i drogës në jetën tuaj?

1. Asnjë
2. Ka ndikuar në marrëdhëniet ndërpersonale
3. Më ka penguar të shpenzoj kohën time më mirë
4. Ka ndikuar në arritjet e mia akademike
5. Kam humbur miqtë si pasojë e përdorimit të drogës
6. Më ka hapur telashe në shtëpi
7. Kam marrë pjesë në konflikte fizike apo kam qenë protagonist në shkatërrimin e një pronësie
8. Ka rezultuar në një aksident, lëndim, arrestim nga policia, ose duke u dënuar në shkollë

12. Çfarë ndikimi ka pasur përdorimi i drogës në arritjet akademike?

1. Nuk ka pasur asnjë efekt negativ
2. Kam pas një rënie të lehtë të rezultateve
3. Nuk kam dëshirë më të mësoj
4. Rrezikoj edhe të ngel për shkak të rezultateve shumë të dobëta që kam

13. Si ndiheni ju personalisht për përdorimin e drogës?

1. Nuk e kam aspak problem
2. Mund ta kontrolloj dhe mund ti vendos vetes kufij
3. Unë mund ta kontrolloj vete por shokët influencojnë lehtë tek unë
4. Më nevojitet ndihmë për të kontrolluar veten
5. Jam duke marrë ndihmë nga profesionist për të bërë të mundur kontrollin e përdorimit të drogës.

PYETËSOR PËR MËSUESIT

DAR/ZA: _____

Zona:

☐

Urbane

☐

Rurale

Gjinia:

☐

Femër

☐

Mashkull

Fusha ku bën pjesë lënda që ju jepni mësim është:

☐

Gjuhët dhe komunikimi

☐

Matematika

☐

Shkencat e natyrës

☐

Shoqëria dhe mjedisi

☐

Teknologjia dhe TIK-u

☐

Arte

☐

Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti

Për pohimet e mëposhtme ju lutem rrethoni alternativën që ju karakterizon.

1. Në ambientet e shkollës ku unë jap mësim:

1. Nuk kam dijeni nëse konsumohet drogë¹
2. Kam dëgjuar nga kolegët apo nga nxënësit që konsumohet drogë, por nuk kam parë asgjë të tillë personalisht
3. Kam dijeni që konsumohet drogë ose e kam konsultuar një gjë të tillë

Sqarim: Pohimit nr. 2 do t'i përgjigjeni nëse në pohimin e mësipërm keni zgjedhur alternativën nr. 3.

¹Termi “drogë” që ju do të gjeni më poshtë gjatë pohimeve i referohet lëndës narkotike të kanabisit, marjuanës dhe hashashit.

2. Kur kam konstatuar që në mjediset e shkollës konsumohet drogë:

1. Nuk kam ndërmarrë asnjë veprim

2. Kam folur me kolegët
 3. Kam vënë në dijeni drejtuesit e shkollës
 4. Kam vënë në dijeni strukturat mbështetëse të shkollës (psikologë, mjek, infermier, etj.)
 5. Kam folur me prindërit
3. Stafi pedagogjik ka nevojë për njohuri shtesë apo materiale të tjera burimore për të nxitur mospërdorimin e drogës nga të rinjtë:
 1. Nuk bie aspak dakord
 2. I/e pavendosur
 3. Bie dakord
 4. Bie totalisht dakord
4. Njohuritë që marrin nxënësit në shkollë për efektet e përdorimit të drogës:
 1. Nuk kam dijeni nëse marrin njohuri
 2. Nuk marrin aspak njohuri
 3. Njohurit që marrin janë të pamjaftueshme
 4. Njohurit që marrin janë të mjaftueshme
5. Në fushën që unë mbuloj, nxënësit:
 1. Nuk marrin asnjë njohuri për drogën
 2. Marrin njohuri të pamjaftueshme për drogën
 3. Marrin njohuri të mjaftueshme për drogën
6. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan edukimi i shkollës për efektet negative të drogës:
 1. Nuk bie aspak dakord
 2. I/e pavendosur
 3. Bie dakord

4. Bie totalisht dakord

7. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luajnë reklamat e televizorit për mospërdorimin e dograve nga të rinjtë:

1. Nuk bie aspak dakord

2. I/e pavendosur

3. Bie dakord

4. Bie totalisht dakord

8. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan edukimi i prindërve për efektet negative të drogës:

1. Nuk bie aspak dakord

2. I/e pavendosur

3. Bie dakord

4. Bie totalisht dakord

9. A ka shkolla juaj politika për parandalimin e përdorimit të drogës nga nxënësit:

1. Nuk jam në dijeni

2. Jo

3. Po

10. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan politikat e shkollës për nxënësit, që janë përdorues të drogës:

1. Nuk bie aspak dakord

2. I/e pavendosur

3. Bie dakord

4. Bie totalisht dakord

11. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan të pasurit e një oficeri policie të pranishëm në shkolle:

1. Nuk bie aspak dakord
2. I/e pavendosur
3. Bie dakord
4. Bie totalisht dakord

12. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan bashkëpunimi i komunitetit për ti mbajtur të rinjtë larg nga përdorimi i drogës:

1. Nuk bie aspak dakord
2. I/e pavendosur
3. Bie dakord
4. Bie totalisht dakord

PYETËSOR PËR PRINDËRIT

DAR/ZA: _____

Zona:

Urbane

Rurale

Punësimi:

I punësuar

I papunë

Pensionist

Tjetër

Statusi civil:

Beqar

I/e martuar

I/e divorcuar

I/e ve

Gjinia:

Femër

Mashkull

Edukimi:

Fillor

8/9-vjeçar

I mesëm

Universitar

Pasuniversitar

Për pohimet e mëposhtme ju lutem rrethoni alternativën që ju karakterizon.

2. Ne dijeninë time fëmija im:

1. E ka provuar drogën¹
2. Është përdorues i drogës
3. Kurrë nuk ka pirë drogë

3. Fëmija im merr nota te mira ne shkollë:

1. Shumë shpesh
 2. Shpesh
-

¹Termi “drogë” që ju do të gjeni më poshtë gjatë pohimeve i referohet lëndës narkotike të kanabisit, marjuanës dhe hashashit.

5. Ndonjëherë
6. Rallë
7. Kurrë

13. Unë i flas fëmijës tim për efektet negative të drogës:

1. Shumë shpesh
2. Shpesh
3. Ndonjëherë
4. Rallë
5. Kurrë

14. Mësuesit i flasin fëmijëve për efektet negative të drogës:

1. Shumë shpesh
2. Shpesh
3. Ndonjëherë
4. Rallë
5. Kurrë

15. Shkolla flet me prindërit për parandalimin e përdorimit të drogës:

1. Shumë shpesh
2. Shpesh
3. Ndonjëherë
4. Rallë
5. Kurrë

16. Forcimi i ligjit jep rezultat në mosfutjen e drogës në shkollë:

1. Shumë shpesh
2. Shpesh
3. Ndonjëherë
4. Rallë
5. Kurrë

17. Mendoni se prania e oficerit të policisë do të parandalonte përdorimin e drogës në ambientet e shkollës:

1. Shumë shpesh
2. Shpesh
3. Ndonjëherë
4. Rallë
5. Kurrë

18. Droga dhe alkooli është një problem shumë i madh për të rinjtë e komunitetit:

1. Shumë shpesh
2. Shpesh
3. Ndonjëherë
4. Rallë
5. Kurrë

9. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luajnë reklamat e televizioneve për mospërdorimin e drogave nga të rinjtë:

1. Nuk bie aspak dakord
2. I/e pavendosur
3. Bie dakord
4. Bie totalisht dakord

10. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luan edukimi i prindërve për efektet negative të drogës dhe alkoolit:

1. Nuk bie aspak dakord
2. I/e pavendosur
3. Bie dakord
4. Bie totalisht dakord

11. Për zgjidhjen e problemeve të drogës një rol të rëndësishëm luajnë aktivitetet pas shkollore për studentet e shkollës:

1. Nuk bie aspak dakord
2. I/e pavendosur
3. Bie dakord
4. Bie totalisht dakord